



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E BRENDSHME  
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE

Nr. 68/25 prot.

Tiranë më, 18.10.2024

V E N D I M

PËR SUBJEKTIN E VLERËSIMIT Z. KUJTIM GJON GJOKA

Nr. 48, datë 18.10.2024

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

**Erjana Pjetri**

**Kryesuese**

**Ersa Karaj**

**Relatore**

**Klevis Dhigoi**

**Anëtar**

Asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga anëtarja e Sekretariatit Teknik, znj. **Ersila Kalaja**, më datë 18.10.2024, ora 10:00, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

**SUBJEKTIT TË VLËRËSIMIT:** **Kujtim Gjon Gjoka**, me funksion Zëvendës drejtor për Hetimin e Krimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

**OBJEKTI:**

Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.

**BAZA LIGJORE:**

**Ligji nr. 12/2018**, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

**Ligji nr. 49/2012**, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

**Rregullore Nr. 197, datë 28.02.2023**, “Për hapat proceduralë të unifikuar”.

## **TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,**

pasi dëgjoi gjetjet dhe rekomandimin e relatores së çështjes Ersa Karaj, vlerësoi shpjegimet e subjektit të vlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit; pasi dëgjoi subjektin e vlerësimit z. Kujtim Gjoka, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin e tij në detyrë; pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në të tre kriteret e vlerësimit, të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2, të nenit 4, të Ligjit nr. 12/2018 të ndryshuar,

### **V Ë R E N:**

#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Agjencia e Mbiqëqyrjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbiqëqyrjes Policore, bazuar në Ligjin nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.
2. Sipas përcaktimeve të nenit 6, të Ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, shtetasi Kujtim Gjon Gjoka është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Trupa e Vlerësimi të Agjencisë së Mbiqëqyrjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit 04.07.2023, si Zv/Drejtor për Sigurinë dhe Policimin në Komunitet, në Drejtorinë Vendore të Policisë Kukës, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
3. Me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm Nr. \*\*\*\*, datë 22.11.2023, gjatë fazës së hetimit administrativ, z. Kujtim Gjoka, është emëruar me detyrë Zëvendësdrejtor për Hetimin e Krimeve në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër, funksion organik i parashikuar në nenin 6, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
4. Subjekti i vlerësimit, z. Kujtim Gjon Gjoka, iu nënshtrua procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar më datë 04.07.2023, nga Trupat e Vlerësimit në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm Nr. 07, datë 17.01.2023 “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të Ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, i ndryshuar”.
5. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me vendimin Nr. \*\*, datë 24.07.2023 u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e Trupës së Vlerësimit e përbërë nga: Znj. Erjana Pjetri (Kryesuese), Znj. Ersa Karaj (Relatore) dhe Z. Klevis Dhigoi (Anëtar).

6. Trupa e Vlerësimit, në përputhje me Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar, si edhe në bazë të Rregullores nr. 197, datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar”, me Vendimin Nr. \*\* prot., datë 24.07.2023, vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Kujtim Gjon Gjoka.
7. Relatori i çështjes, Znj. Ersa Karaj, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar datë 28.07.2023, ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, ku i është bërë e njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e Trupës së Vlerësimit.
8. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në rrugë elektronike më datë 29.07.2023, duke u shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e Trupës së Vlerësimit.
9. Relatori i çështjes në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3, të nenit 25, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.
10. Në vijim të procesit për subjektin e vlerësimit Z. Kujtim Gjoka, mbështetur në nenin 33/1, nenin 42 dhe nenin 46, të Ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, relatori i çështjes ka dërguar pranë institucioneve ndihmëse, si më poshtë vijon:
  - Formularin e deklaramentit të pasurisë dhe dokumentacioni shoqërues, me shkresën Nr. \*\* Prot., datë 25.07.2023, pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ( në vijim ILDKPKI).
  - Formularin e Vlerësimit të Aftësive Profesionale me shkresë përcjellëse Nr. \*\* Prot., datë 25.07.2023, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
  - Formularin e Kontrollit të Figurës me shkresë përcjellëse Nr. \*\* Prot., datë 25.07.2023, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
11. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, Trupa e Vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.
12. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve, bazuar në nenin 4, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka për objekt:
  - Vlerësimin e pasurisë;
  - Kontrollin e figurës;
  - Vlerësimin e aftësive profesionale.
13. Trupa e Vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:

- a. Ligjin nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar;
- b. Ligjin nr. 128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”;
- c. Ligjin nr. 40/2015, “Kodi i Procedurës Administrative”;
- d. Ligjin nr.9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”;
- e. Udhëzim i Ministrit të Brendshëm Nr.7, datë 17.01.2023 “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të Ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, i ndryshuar”;
- f. Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe ILDKPKI Nr.15, datë 27.01.2023, “Për miratimin e formularëve të deklarimit të pasurisë për vlerësimin kalimtar dhe periodik, si edhe mënyrën e plotësimit të tyre nga subjektet e vlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarimin e pasurisë në zbatim të ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” i ndryshuar;
- g. Rregulloren nr. 197, datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar”.

14. Gjithashtu, Trupa e Vlerësimit ka verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet e rrethanat e nevojshme dhe konkretisht:

- ❖ *Deklaratën e Pasurisë;*
- ❖ *Deklaratën për Kontrollin e Figurës;*
- ❖ *Formularin e Vlerësimit Profesional;*
- ❖ *Dokumentacionin bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklaratimet;*
- ❖ *Aktin e përfundimit të vlerësimit të pasurisë, nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave;*
- ❖ *Raportin mbi vlerësimin e aftësive profesionale, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;*
- ❖ *Raportin mbi Kontrollin e Figurës, nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore;*
- ❖ *Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar;*
- ❖ *Provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit;*
- ❖ *Bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.*

15. Trupa e Vlerësimit më datë 20.09.2024, pasi dëgjoji relatorin, krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Kujtim Gjoka, me Vendimin Nr. \*\*, datë 20.09.2024, vendosi:

- a. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Kujtim Gjon Gjoka.
- b. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:
  - *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;*
  - *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët: vlerësimin pasuror, kontrollin e figurës dhe atë profesional.*
- c. Të ftojë subjektin për t'u njohur me dosjen dhe provat e administruara nga Trupa e Vlerësimit, në përputhje me nenin 50, të ligjit nr. 12/2018 të ndryshuar, nenet 35-40 dhe 45-47 të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme për t'u njohur me dosjen dhe të paraqesë shpjegime.

16. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pikat 12 dhe 14, të Ligjit nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, si dhe nenit 3, pika 11 dhe nenit 5, të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

17. Seanca dëgjimore për subjektin e vlerësimit z. Kujtim Gjoka, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, si dhe Kodin e Procedurave Administrative, më datë 08.10.2024, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, salla e mbledhjeve, Tiranë.
18. Në këtë seancë subjekti i vlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, si dhe shprehu opinionin e tij në lidhje me procesin e vlerësimit të kryer duke kërkuar konfirmimin në detyrë.
19. Trupa e Vlerësimit zhvilloi seancën e dhënies së vendimit më datë 18.10.2024.

## **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT**

20. Subjekti i vlerësimit z. Kujtim Gjon Gjoka, ka qenë bashkëpunues dhe korrekt gjatë gjithë procesit të vlerësimit në përputhje me pikën 2, të nenit 48, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
21. Subjekti ka paraqitur që në fazën e dorëzimit të deklaratave dokumentacion shoqërues të vlerësuar nga ana e tij, si dhe gjatë fazës së hetimit administrativ, gjatë komunikimit dhe pyetjeve të drejtuara, është përgjigjur dhe ka përcjellë dokumentacion shoqërues/justifikues shtesë, me qëllim vërtetësinë e deklaratimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, sipas rastit dhe rrethanave të tjera të çështjes për sqarim.

## **IV. PROCESI I VLERËSIMIT NGA TRUPA E VLERËSIMIT**

## A. VLERËSIMI I PASURISË

22. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, “Vlerësimi i pasurisë”, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, e veçanërisht në nenin 31, të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarin dhe kontrollin e pasurive, ligjshmërinë e burimit të krijimit të tyre dhe përmbushjen e detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.
23. Në zbatim të nenit 32, pika 2, e Ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit Z. Kujtim Gjoka ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 08.05.2023. Formulari i Pasurisë ka Nr. Indeksi \*\*, viti 2023.
24. Procedurat e deklarinimit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32 dhe nenit 33, ndërsa vlerësimi i pasurisë nga Trupa e Vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
25. Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në institucionet apo personat juridikë, publikë apo privatë.
26. Trupa e Vlerësimit hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar.
27. Gjithashtu, ka kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite, burimin e krijimit, shlyerjen e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të.
28. **Trupa e Vlerësimit për realizimin e procesit të vlerësimit të pasurisë administroi:**
  - Deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin bashkëlidhur.
  - Raportin e hollësishëm të përgatitur nga ILDKPKI në zbatim të neneve 33/1 dhe 34, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
  - Provat shkresore/dokumente të vëna në dispozicion nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar.
  - Shpjegimet e subjektit për burimin e të ardhurave, mbulimin e shpenzimeve dhe të detyrimeve financiare.
  - Dokumentacionin e paraqitur në deklarinimet e subjektit, si përgjigje të pyetjeve të dërguara nëpërmjet postës elektronike.

29. **Hetimi administrativ i kryer nga Trupa e Vlerësimit konsistoi në:**

- Verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit;
- Verifikimin e burimit/eve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruar si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme;
- Evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim;
- Evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.

### 30. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja:

30.1 Kujtim Gjoka nuk ka qenë dhe nuk është subjekt deklarues në ILDKPKI.

30.2 ILDKPKI-ja në përputhje me Ligjin Nr.9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publik”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, në Ligjin Nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave”, i ndryshuar, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative, ka dërguar një raport të hollësishëm Nr. \*\* Prot., datë 20.03.2024, bazuar në dokumentacionin e administruar, për subjektin e vlerësimit z. Kujtim Gjoka, ku është konstatuar se:

- a) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;
- b) nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- c) nuk është kryer fshehje e pasurisë;
- d) nuk është kryer deklarim i rremë;
- e) subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.

### DEKLARIM I PASURIVE NGA SUBJEKTI I VLERËSIMIT, KUJTIM GJON GJOKA

1. **Autoveturë tip Volkswagen Passat**, prodhimi i vitit 2001, e blerë.

**Burimi i krijimit:** nga kursimet familjare ndër vite. Automjeti është nxjerrë nga qarkullimi më 24.11.2020. Targa AA\*\*\*\*L.

**Vlera:** 500 euro.

**Pjesa takuese:** 100 %.

1.1 Subjekti ka bashkëlidhur deklaratës së pasurisë dokumentacionin:

- Kontratë shitblerje nr.\*\* rep., nr. \*\* kol., datë 05.08.2017. Bashkëlidhur praktika.

**HETIMI ADMINISTRATIV**

1.2 Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara, mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, ILDKPKI dhe Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, kanë kryer hetimin administrativ, nga ku rezulton se:

1.3 Referuar kontratës së shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 05.08.2017, pala shitëse Gj. S. i ka shitur subjektin të vlerësimit automjetin tip VW Passat, viti 2001, me targë AA\*\*\*L, në vlerën 500 euro. Bashkëlidhur praktika.

1.4 **DPSHTRR**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.11.2023, konfirmon se shtetasi Kujtim Gjoka, ka pasur të regjistruar mjetin me targa AA\*\*\*L, **me status cregjistrim i përhershëm**. Bashkëlidhur kontrata e shitblerjes.

1.5 Në përfundim të verifikimit dhe analizës së kryer, rezulton se;

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR.**
- ✓ **Subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për krijimin e kësaj pasurie të luajtshme.**

2. **Autoveturë tip Wolksvagen Passat**, prodhimi i vitit 2006, e blerë.

**Burimi i krijimit:** kursime familjare. Targa AA\*\*\*O, shitur më datë 03.03.2022 me vlerë 3.000 euro.

**Vlera:** 990 euro.

**Pjesa takuese:** 100 %.

2.1 Subjekti ka bashkëlidhur dokumentacion justifikues:

- Kontratë shitblerje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.08.2020.
- Kontratë shitblerje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 03.03.2022.

## **HETIMI ADMINISTRATIV**

2.2 **DPSHTRR**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.11.2023, konfirmon se shtetasi Kujtim Gjoka, ka pasur të regjistruar mjetin me targa AA\*\*\*O.

2.3 Referuar kontratës së shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.08.2020, pala shitëse B. K. i shet palës blerëse Kujtim Gjoka, automjetin tip VW Passat, viti 2006, në vlerën 990 euro (122.520 lekë, sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, datë 22.08.2020).

2.4 Referuar kontratës së shitblerjes datë 03.03.2022, pala shitëse Kujtim Gjoka i shet shtetasit A. H. automjetin tip VW Passat, viti 2006, në vlerën 3.000 euro (368.040 lekë, sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë, datë 03.03.2022).



2.5 Në lidhje me ndryshimin ndërmjet vlerës së blerjes dhe vlerës së shitjes së automjetit të sipërcituar, (me një diferencë prej 2,010 euro), me inventarin e datës 11.03.2024, si dhe në përgjigjet e datës 09.09.2024, drejtuar relatores së çështjes, subjekti ka paraqitur dokumentacion justifikues, si dhe sqarime me shkrim, ku sqaron se ka kryer shërbime të automjetit në vlerën 125.000 lekë, sipas faturës së datës 02.09.2021. Gjithashtu, deklaroi se ka kryer edhe shërbime të tjera, siç ka qenë blerja e gomave të reja me disqe (blerë me para në dorë), në vlerën 50.500 lekë, që kanë rritur vlerën e automjetit.

2.6 Subjekti ka bashkëlidhur faturë nga subjekti \*\*\*\*\* shpk, datë 04.09.2021, për shërbime të automjetit tip VW, targa A\*\*\*O, në emër të Kujtim Gjoka, në vlerën 125.000 lekë.

✓ Në këto rrethana të kryerjes së shërbimeve dhe investimeve në automjetin me targa AA\*\*\*\*O, duke bashkëlidhur edhe faturën në kohën e kryerjes së riparimit, vlera e automjetit është rritur në shumën 298.020 lekë.

✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR.

3. Tokë arë në fshatin Kaçinar Mirditë, me sipërfaqe 2.368 m<sup>2</sup>.

**Vlera:** e pacaktuar.

**Burimi i krijimit:** përfituar nga Ligji nr. 7501.

**Pjesa takuese:** 100 %.

3.1 Subjekti ka bashkëlidhur vërtetim nga ZVRPP Mirditë, datë 16.04.2018.

## HETIMI ADMINISTRATIV

3.1 **ASHK Mirditë**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.10.2023, nuk konfirmon pasuri të regjistruar në emër të subjektit apo personave të lidhur.

3.2 Referuar vërtetimit nga ZVRPP Mirditë, datë 16.04.2018, rezulton se Kujtim Gjoka ka të regjistruar në fshatin Kaçinar, tokë arë, me sipërfaqe totale 2.368 m<sup>2</sup>, zk. \*\*\*.

3.3 Gjithashtu, subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues, konkretisht aktin e marrjes së tokës në pronësi, datë 26.03.2008, ku rezulton se në mbështetje të ligjit nr. 7501, familjes së Kujtim Gjoka, nga fshati Kaçinar, i jepet në pronësi tokë arë, me sipërfaqe gjithsej 2.368 m<sup>2</sup>. Bashkëlidhur praktika.

3.4 Në përfundim të verifikimit dhe hetimit të kryer, rezulton se;

✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar për pasurinë tokë arë në fshatin Kaçinar, Mirditë.

4. **Ndërtesë me sipërfaqe 88.65 m<sup>2</sup>** dhe truall me sipërfaqe 240 m<sup>2</sup>. Fitimi i pronësisë me lejen e legalizimit nr. \*\*\*, datë 28.06.2018. Ndërtuar në vite, me kursime familjare.

**Vlera** 1.800.000 lekë.

**Zotëron** 50 %.

4.1 Bashkëlidhur deklaratës:

- Certifikata e regjistrimi të pronësisë datë 02.11.2022.
- Leje legalizimi, nr. \*\*\*, datë 28.06.2018.

4.1 **ASHK Lezhë**, me shkresën nr. \*\* prot., datë 25.09.2023, nuk konfirmon pasuri të regjistruar në emër të subjektit dhe personave të lidhur.

4.2 **ASHK Drejtoria Vendore Lezhë**, me e-mailin e datës 05.03.2024, ka bashkëlidhur dokumentacionin:

- Deklaratë për përfshirjen në procedurat e legalizimit, datë 10.03.2017, nga Kujtim Gjoka, për ndërtim pa leje, ngritur në vitin 2013, me adresë në Shëngjin, Lezhë.
- Kartela e pasurisë me nr. \*\*\* zk. \*\*\*, e llojit truall me sipërfaqe 240 m<sup>2</sup>, ndërtesë 88.65 m<sup>2</sup>, në emër të Kujtim dhe Anduela Gjoka. Pasuria ka shënimin “Leje legalizimi, fatura trualli, VKM nr. 488, datë 21.07.2022”. Data e regjistrimit 02.11.2022.

4.3 **BKT**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.08.2023, konfirmon në emër të Anduela Gjoka, kredi në lekë, me gjendje detyrimi në datë 08.05.2023, në vlerën 972.203 lekë. Kredia rezulton e disbursuar në datën 29.03.2007, në vlerën 2.940.000 lekë. Për periudhën 02 - 03.04.2007 tërheq nga llogaria në total 2.910.000 lekë, me përshkrimin “Anduela Gjoka, tërheqje nga llogaria me kërkesë bashkëngjitur”.

4.4 Në lidhje me ndërtesën e deklaruar si më sipër, më datë 01.03.2024, subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues, si dhe sqarime me shkrim, ku ka sqaruar se punimet për ndërtimin e këtij objekti kanë filluar në vitin 2007 dhe kanë përfunduar në vitin 2013. Punimet janë kryer nga punëtori të ndryshme, jo të kualifikuar, sipas zërave të ndërtimit dhe sipas periudhës. Thekson se në çdo proces të ndërtimit, për shkak të reduktimit të kostos kanë punuar vetë familjarisht, bashkë me babain. Kjo vlerë ndërtimi është deklaruar bazuar në preventivin bashkëlidhur, referuar çmimeve të ndërtimit, sipas VKM-së nr. 629, datë 15.07.2015. Pasuria është përfituar nga procesi i legalizimit me lejen e legalizimit nr. \*\*\*\*\*, datë 28.06.2018, ku toka ka qenë shtetërore. Aktualisht objekti nuk është në funksionim dhe është i mbyllur, duke mos u përdorur për banim apo qëllim tjetër. Nuk ka kosto mobilimi, pasi objekti është i pamobiluar. Subjekti sqaron se nga përdorimi i kredisë në vlerën 3.000.000 lekë, marrë nga bashkëshortja Anduela Gjoka është përdorur vlera 1.472.700 lekë, për ndërtimin e banesës me sipërfaqe 88.65 m<sup>2</sup>.

4.5 Në mbështetje të sqarimeve të tij, subjekti ka bashkëlidhur dokumentacionin, si më poshtë:

- Preventiv punimesh, përpiluar nga shoqëria \*\*\*\* shpk, për objekt banimi me adresë në Ishull Lezhë, në emër të Kujtim dhe Anduela Gjoka. Vlera e punimeve të ndërtimit të godinës është në shumën e preventivuar prej 1.838.202 lekë, hartuar në bazë të manualit të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave të tyre me VKM nr. 629, datë 15.07.2015.
- Foto aktuale të objektit të deklaruar nga subjekti.

4.7 Në lidhje me burimin financiar të deklaruar për ndërtimin e objektit, mw datë 11.03.2024, subjekti ka paraqitur dokumentacion justifikues, si dhe sqarime me shkrim, ku sqaron se në momentin e plotësimit të formularit të deklarimit është konsideruar si kursim familjar edhe vlera e kredisë bankare të përdorur prej 1.472.700 lekë, duke i shtuar edhe vlerën tjetër prej 327.300 lekë, nga kursimet familjare.

4.8 Trupa e Vlerësimit, kreu analizën financiare për subjektin e vlerësimit dhe personat e lidhur me të, mbi mundësinë për kursim për krijimin e kësaj pasurie dhe mundësinë e shlyerjes së kredisë së marrë, duke llogaritur për çdo vit të ardhurat e subjektit të vlerësimit, bashkëshortes dhe prindërve të tij, shpenzimet jetike sipas INSTAT dhe shpenzimet për pagesë kredie (principal + interesa); ku në përfundim të hetimit rezulton se:

- ✓ **Subjekti ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie dhe për shlyerjen e kredisë së marrë për këtë qëllim.**
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ASHK dhe BKT.**

5. **Llogari bankare** në Raiffeisen Bank për kalimin e pagës si punonjës policie me gjendje në llogari në datën 27.04.2023, në shumën 193.066 lekë, ku 120.000 lekë janë overdraft i ofruar nga banka.

**Vlera** 73.066 lekë nga paga.

**Pjesa takuese:** 100 %.

5.1 Subjekti ka bashkëlidhur deklaratës vërtetim mbi produktet bankare të Kujtim Gjoka, datë 18.04.2023, për llogari rrjedhëse në lekë, për periudhën 2005 - 2023.

5.1 **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\* prot., datë 10.08.2023, konfirmon në emër të Kujtim Gjoka, llogari page në lekë, me gjendje në datë 08.05.2023, në vlerën 147.835 lekë, dhe overdraft në vlerën -120.000 lekë.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Raiffeisen Bank.**
- ✓ **Burimi i krijimit është trajtuar më poshtë tek të ardhurat nga punësimi.**

6. **Llogari bankare** në Credins Bank për kalimin e shpërblimeve si anëtar bordi në \*\*\*\*Security me gjendje në datën 27.04.2023, vlera 139.020 lekë. Zotëron 100%.

6.1 Bashkëlidhur deklaratës:

- Statement nga Credins Bank, datë 15.02.2023, për llogari në lekë, në emër të Kujtim Gjoka, për periudhën 06.02.2019 – 31.01.2023.

6.2 **Credins Bank**, me shkresën nr. \*\* prot., datë 04.10.2023, konfirmon në emër të Kujtim Gjoka, llogari page në lekë, me gjendje në datë 08.05.2023, në vlerën 138.660 lekë.

6.3 Trupa e Vlerësimit mori në shqyrtim dokumentacionin e përcjellë nga subjekti i vlerësimit, nga ku rezultoi se:

6.4 Kujtim Gjoka ka nënshkruar një marrëveshje, datë 06.01.2019, me \*\*\* shpk, me objekt rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve gjatë ushtrimit të funksionit të anëtarit të Bordit Akademik të Qendrës së Trajnimit Privat \*\*\* Lezhë nga ana e z. Kujtim Gjoka, *në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm dhe Rregullores së Trajnimit Privat.*

6.5 Gjithashtu, referuar urdhrin nr. 21, datë 10.01.2019, të Qendrës së Trajnimit Privat \*\*\*, vërehet se është urdhëruar që për trajtimin financiar të punës së kryer nga Bordi Akademik i QTP-së, për çdo mbledhje do të jetë 10.000 lekë për anëtar, për çdo orë mësimi 350 lekë. Tatimi do të mbulohet nga subjekti.

✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Credins Bank.**

7. **Gjendje cash**, shuma 150.000 lekë.  
Zotëron 100 %.

7.1 Me inventarin e datës 01.03.2024, subjekti ka dorëzuar sqarime me shkrim, në lidhje me burimin e gjendjes cash, ku sqaron se burimi janë nga të ardhurat e tyre familjare.

✓ **Nga kryeja e analizës financiare nga ana e Trupës së Vlerësimit, mbi mundësinë për kursim për krijimin e pasurisë gjendje cash, rezulton se të ardhurat mundësojnë gjendjen e deklaruar.**

8. **Llogari bankare** në Raiffeisen Bank në euro, e përfunduar, hapur në datë 24.01.2013 dhe mbyllur në 31.12.2017, ku në datën 25.01.2014 janë dërguar nga E. L. 424 euro, për t'i tërhequr unë dhe dërguar prindërve të tij, që janë në moshë të vjetër.

**Vlera** 424 euro.

**Zotëron** 100 %.

8.1 Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim mbi produktet bankare të Kujtim Gjoka, datë 18.04.2023, për llogari rrjedhëse në euro, për vitin 2013.

8.1 **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\* prot., datë 10.08.2023, konfirmon në emër të Kujtim Gjoka, llogari në euro, ku konfirmohet kreditimi i vlerës 424 euro nga E. L., më datë 25.01.2013, e cila tërhiqet nga llogaria në të njëjtën datë. Llogaria rezulton në vlerën 0 euro.

8.2 Subjekti ka dhënë sqarime me shkrim pranë Trupës së Vlerësimit mbi këtë transaksion, si dhe ka bashkëlidhur një deklaratë noteriale të motrës së E. L., shtetases V. L., e cila kujdeset për prindërit dhe vërteton faktin e marrjes së këtyre të hollave të transferuara nga i vëllai.

✓ **Konfirmohet deklarami me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Raiffeisen Bank.**

## **DEKLARIMI I TË ARDHURAVE**

9. Të ardhura nga paga ime, dieta, shpërblime etj., si punonjës policie, nga data 01.10.1997 deri në 18.04.2023, shuma 19.669.218 lekë.

10. Të ardhura nga taksa e solidaritetit për punonjësit e policisë, për periudhën nga data 01.01.1998 deri në datën 31.12.2002, shuma 298.000 lekë.

11. Të ardhura nga paga si anëtar i Bordit Akademik të Qendrës së Forumit Profesional \*\*\* Security, nga data 06.01.2019 deri më 18.04.2023, shuma 220.000 lekë.

12. Të ardhura nga shitja e autoveturës tip Volkswagen Passat me targa AA\*\*\*O, shuma 3.000 euro.

13. Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetime mbi bazën e vlerësueshme nga ISSH, me punëdhënëses DVP Lezhë, për shtetasin Kujtim Gjoka, periudha tetor 1997 —prill 2005, ku konfirmohen kreditimet nga paga neto, në vlerën totale rreth 2.171.000 lekë.
- Marrëveshje, datë 06.01.2019, me palë subjektin \*\*\*shpk, dhe Kujtim Gjoka, mbi rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve gjatë ushtrimit të funksionit të anëtarit të Bordit Akademik të QTP-së \*\*\*\*Lezhë.
- Urdhër nr. 21, datë 10.01.2019 nga \*\*\*\*, ku është urdhëruar për trajtimin financiar të punës së kryer nga Bordi Akademik i QTP-së.
- Statement nga Raiffeisen Bank, datë 27.04.2018, për llogari në lekë, në emër të Kujtim Gjoka, për periudhën 25.01.2013.

14. **ISSH**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.08.2023, konfirmon pagat neto të Kujtim Gjoka, për periudhën janar 2012 - korrik 2023, nga Drejtoria e Policisë Qarkut Lezhë, Drejtoria e Policisë Qarkut Shkodër dhe Drejtoria Vendore e Policisë Kukës.

15. **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. \*\* prot., datë 10.08.2023, konfirmon në emër të Kujtim Gjoka, llogari në lekë, ku konfirmohen kreditimet nga paga, për periudhën maj 2005 - maj 2023, në vlerën totale rreth 17.615.000 lekë.

16. **Credins Bank**, me shkresën nr. \*\* prot., datë 04.10.2023, konfirmon në emër të Kujtim Gjoka, llogari page në lekë, ku konfirmohen kreditimet nga paga për periudhën shkurt 2019 - dhjetor 2022, nga \*\*\*shpk, paga bordi akademik, në vlerën totale rreth 220.500 lekë.

17. Me inventarin e datës 01.03.2024, subjekti ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim nga Komuna Kaçinar, Mirditë, datë 18.9.1996, që vërteton se Kujtim Gjoka ka punuar mësues, në shkollën 8 vjeçare Kaçinar-Arrës dhe është paguar nga datë 1 shtator 1992, deri më 30 shtator 1994.
- Vërtetim mbi bazën e vlerësueshme nga ISSH, që konfirmon pagat bruto të Kujtim Gjoka, për periudhën janar - shtator 1994, në vlerën totale rreth 34.581 lekë.

✓ **Të ardhurat e subjektit për periudhën janar 1994 - maj 2023, janë të dokumentuara në vlerën totale rreth 20.041.000 lekë. Për periudhën 1992 - 1993 punësimi është dokumentuar në terma jo financiarë.**

## **SHPENZIMET E DEKLARUESHME**

**A. Shpenzime të vitit të fundit kalendarik për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit ose personave të lidhur. Periudha 01.01.2022 - 31.12.2022.**

18. Subjekti i vlerësimit ka deklaruar:

18.1 Shpenzime për furnizimin me ujë dhe largim të ujërave të ndotur për vitin 2022, sipas kontratës me UK Lezhë. Shuma 31.961 lekë.

18.2 Shpenzime për energji elektrike, sipas kontratës me nr. \*\*\* me OSHE, për vitin 2022. Shuma 32.805 lekë.

18.3 Shpenzime për telefon fiks, internet, televizion me ish Albtelecom, për numrin \*\*\*\*, për vitin 2022. Shuma 41.362 lekë.

18.4 Shpenzime për telefona celular me numër 069\*\*\*\*9 dhe 069\*\*\*\*0, për vitin 2022. Shuma 17.400 lekë.

18.5 Shpenzime për pagesë të furnizimit me energji elektrike, sipas kontratës me nr. \*\*\*\* për banesën e prindërve në fshatin Kaçinar Mirditë, për vitin 2022. Vlera 17.778 lekë.

18.6 Shpenzime për telefona celular të bashkëshortes, fëmijëve, prindërve për vitin 2022. Vlera 66.060 lekë.

## **HETIMI ADMINISTRATIV**

19. Trupa e Vlerësimit mori në shqyrtim dokumentacionin e përcjellë nga subjekti i vlerësimit si dhe përgjigjet e institucioneve përkatëse, konkretisht:

- Librezë energjie, filiali Lezhë, në emër të Gjon Gjoka, ku rezultojnë pagesa për vitin 2022, në vlerën totale rreth 33.000 lekë.
  - Librezë telefonike, filiali Lezhë, në emër të Kujtim Gjoka, ku rezultojnë pagesa për vitin 2022, në vlerën totale rreth 30.000 lekë.
  - Librezë uji, ujësjellësi Lezhë, në emër të Kujtim Gjoka, ku rezultojnë pagesa për vitin 2022, në vlerën totale rreth 32.000 lekë.
  - Librezë nga Cez shpërndarje, Mirditë, Kaçinar, në emër të Gjon Gjoka, ku ka bashkëlidhur tabelë pagesash për vitin 2022, në vlerën totale rreth 17.700 lekë.
20. FSHU, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.08.2023, konfirmon në emër të Kujtim Gjoka, 21 kontrata furnizimi me energji elektrike, në instancat Shijak, Berat, Durrës, Tiranë, Burrel, Kukës, Lushnje.
  21. FSHU, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 23.11.2023, konfirmon në emër të Gjon Gjoka, 1 abonent në instancën Kaçinar. Pagesat për vitin 2022 janë në total 18.114 lekë. Konfirmon gjithashtu 21 kontrata furnizimi me energji elektrike, në instancat Shkodër, Lezhë, Burrel, Durrës, Tiranë.
  22. UK Tiranë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.08.2023, konfirmon në emër të Kujtim Gjoka, kontratë në rrugën “Ali Demi”, “Ferit Xhajko” dhe “Kodër e Kuqe”, Kamëz. Në emër të Anduela Gjoka, me adresë në rrugën “Lek Dukagjini”. Pagesat për vitin 2022 janë në vlerën totale 2.880 lekë.
  23. UK Dibër, me shkresën nr. \*\* prot., datë 16.01.2024, konfirmon në emër të Kujtim Gjoka dy abonentë në instancat Mat dhe Bulqizë.
  24. UK Lezhë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.08.2023, konfirmon në emër të Kujtim Gjoka, kontratë furnizimi në adresën \*\*\*, Lezhë. Pagesat janë për vitin 2023.
  25. Vodafone, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 01.02.2024, konfirmon në emër të Kujtim Gjoka numrin 0698\*\*\*0, në emër të DP Lezhë (Kujtim Gjoka), 069\*\*\*9 dhe në emër të Enis Gjoka numrat 069\*\*\*2, 069\*\*\*0 dhe 069\*\*\*8. Pagesat totale për Kujtim dhe Enis Gjoka për vitin 2022, janë në vlerën totale 41.818 lekë.
  26. Vodafone, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.12.2023, konfirmon në emër të Gjon Gjoka numrat 068\*\*\*5 dhe 068\*\*\*0. Pagesat totale janë në vlerën 19.500 lekë.
  27. One Albania, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.09.2023, konfirmon në emër të Kujtim Gjoka, numrin 355\*\*\*7. Pagesat për vitin 2022 janë në vlerën totale 30.745 lekë.
  28. One Albania, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 13.12.2023, nuk konfirmon numra të regjistruar në emër të Gjon dhe Davë Gjoka.

29. Tring Albania, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 31.08.2023, nuk konfirmon kontratë të nënshkruar nga subjekti apo personat e lidhur.
30. Tring Albania, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.11.2023, nuk konfirmon kontratë të nënshkruar nga Gjon dhe Davë Gjoka.
31. Abissnet, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 04.09.2023, nuk konfirmon kontratë të nënshkruar nga subjekti apo personat e lidhur.
32. Digicom, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.08.2023, nuk konfirmon abonent të regjistruar në emër të subjektit apo personave të lidhur.
33. Digicom me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 24.11.2023, nuk konfirmon abonent të regjistruar në emër të subjektit apo personave të lidhur.
34. 12 Shoqëritë Rajonale të Ujësjellës-Kanalizime, konfirmojnë se subjekti apo personat e lidhur, nuk figurojnë të kenë lidhur kontrata për shërbim furnizimi me ujë të pijshëm, pranë këtyre shoqërive rajonale.
35. 15 Shoqëritë Rajonale të Ujësjellës- Kanalizime, konfirmojnë se Gjon Gjoka dhe Davë Gjoka, nuk figurojnë të kenë lidhur kontrata për shërbim furnizimi me ujë të pijshëm, pranë këtyre shoqërive rajonale.
36. Në lidhje me konfirmimet e FSHU dërguar me shkresën nr. \*\*\*, datë 17.08.2023, subjekti ka dorëzuar sqarime me shkrim me inventarin e datës 01.03.2024, ku sqaron dhe deklaron me përgjegjësi të plotë se nuk disponon asnjërin prej 21 kontratave të furnizimit me energji elektrike në instancat Shijak, Berat, Durrës, Tiranë, Burrel, Kukës, Lushnje.
37. Lidhur me konfirmimet e FSHU, dërguar me shkresën nr. \*\*\*, sqaron se babai Gjon Gjoka, disponon kontratën në instancën Kaçinar, ku për vitin 2022 vlera e paguar në total ka qenë 18.114 lekë. Gjithashtu sqaron se babai Gjon Gjoka disponon kontratën nr. \*\*\*, në instancën Lezhë. Kontratat e tjera në instancat Shkodër, Burrel, Durrës, Tiranë, nuk janë në emrin e babit të tij.
38. Lidhur me konfirmimet e UK Tiranë, dërguar me shkresën nr. \*\*\*, datë 30.08.2023, sqaron dhe deklaron se subjekti dhe bashkëshortja e tij, nuk disponojnë asnjërin prej kontratave të furnizimit me ujë, në rrugën “Ali Demi”, “Ferit Xhajko”, “Kodër e Kuqe”, Kamëz dhe rruga “Lek Dukagjini”.
39. Lidhur me konfirmimet e UK Dibër, dërguar me shkresën nr. \*\*\*, datë 12.01.2024, sqaron se nuk disponon asnjërin prej kontratave të furnizimit me ujë në Mat dhe Bulqizë.



40. Lidhur me konfirmimet e UK Lezhë, dërguar me shkresën nr. \*\*\*, datë 22.08.2023, sqaron se disponon kontratën me numër 2\*\*\*4, të furnizimit me ujë, të lidhur me UK Lezhë.
41. **Trupa e vlerësimit konstaton se**, për faktet e sipërpërmendura, në lidhje me numrin e madh të abonentëve me gjeneralitetet Kujtim Gjoka, **nuk provohet fakti se këta abonentë janë me gjeneralitetet e plota** si subjekti i vlerësimit Kujtim Gjon Gjoka, pasi nuk provohet as atësia dhe as numri i identifikimit.
42. Gjithashtu, edhe për abonentët në emër të babait Gjon Gjoka, nuk provohet fakti se këta abonentë janë me gjeneralitete të plota si z. Gjon Kol Gjoka, pasi nuk provohet atësia dhe/ose numri i identifikimit.
- ✓ **Shpenzimet për ujë, drita, telefon dhe internet, gjatë periudhës së sipërcituar, me kontrata në emër të subjektit dhe personave të lidhur, rezultojnë në total rreth 205.000 lekë.**
- B. Shpenzime për udhëtime private, personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 viteve të fundit (kalendarike), duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen dhe shpenzimet e përballuara. Periudha 01.01.2020 - 31.12.2022.**

43. Subjekti i vlerësimit ka deklaruar:

- 43.1 Shpenzime udhëtimi për dalje jashtë shtetit në Angli, nga data 09.04.2022 deri në datën 15.04.2022, për vete dhe bashkëshorten. Të gjitha shpenzimet për këtë vizitë janë përballuar nga lidhja ime shoqërore dhe familjare E. S., që jeton e punon familjarisht prej vitesh në Londër, ku drejton një biznes të tijin. Qëllimi i udhëtimit ka qenë për të marrë pjesë në ceremoninë e dy vjetorit të vdekjes së vëllait të tij dhe shokut tim të ngushtë G. S., pasi në momentin e vdekjes ka qenë e pamundur të bëhej një ceremoni e tillë për shkak të pandemisë së Covid19. Shpenzimet e mia në këtë udhëtim kanë qenë për lekë xhepi gjatë ditëve të qëndrimit në Londër. Vlera 400 euro.
- 43.2 Shpenzime udhëtimi për dalje jashtë shtetit, për vete, në Malin e Zi, në datën 11.01.2020 me kthim brenda së njëjtës ditë, për përcjelljen e prindërve të lidhjes shoqërore të ngushtë në aeroportin e Podgoricës. Vlera 5.000 lekë.
- 43.3 Shpenzime udhëtimi për dalje jashtë shtetit në Malin e Zi, Ulqin, për djalin Enis Gjoka në datën 10.02.2023 ora 23.00 dhe kthim në datën 11.02.2023 ora 05:49, për të ndjekur koncertin e një këngëtarit të preferuar. Vlera 10.000 lekë.

## **HETIMI ADMINISTRATIV**

44. Trupa e Vlerësimit mori në shqyrtim dokumentacionin e përcjellë nga subjekti i vlerësimit si dhe përgjigjet e institucioneve përkatëse, konkretisht:

45. Dokumentacion (në gjuhën Angleze), “letër ftuese”, datë 20.02.2022, ku shtetasi E. S., dëshiron të ftojë shtetasin Kujtim Gjoka dhe bashkëshorten e tij në Britaninë e Bashkuar, në dy vjetorin e humbjes së vëllait nga Covid 19. Konfirmon se jeton me familjen në Britaninë e Bashkuar, me bashkëshorten E. S. dhe me fëmijët A. S. dhe Ch. S. Deklaron se jetojnë në një shtëpi me 4 dhoma. Gjithashtu disponojnë edhe shtëpi pritje me dy dhoma. Deklaron se ai dhe bashkëshortja e tij zotërojnë dy kompani dhe kanë të ardhura vjetore rreth 160.000 GBP. Shoku i tij nuk ka vizituar kurrë UK dhe do vijë për përvjetorin e vëllait të ftuesit. Të gjitha shpenzimet e vizitës në UK do të përballohen nga ftuesi. Në këtë dokumentacion ka firmosur edhe bashkëshortja e ftuesit. Bashkëlidhur praktika.
46. Me inventarin e datës 01.03.2024, subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues, si dhe sqarime me shkrim, ku sqaron se paraqet printime nga sistemi Tims, të daljeve dhe hyrjeve jashtë vendit, për periudhën 2020 - 2022 të tij dhe familjarëve të tij. Subjekti sqaron se udhëtimi i tij, bashkë me bashkëshorten në Angli, në vitin 2022 ka qenë për përkujtimoren e mikut të familjes G. S., ndërruar jetë gjatë pandemisë më datë 19 prill 2020. Kjo ceremoni është zhvilluar në pamundësi për të zhvilluar ceremoni varrimi apo në një vjetor, për shkak të kufizimeve të Covid 19. Bashkëlidhur janë dokumentet e ftesës, rezervimi i biletave dhe hotelit. Shpenzimet e udhëtimit janë mbuluar nga vëllai i të ndjerit, mik familje E.S., i cili banon dhe ushtron aktivitetin e tij ekonomik në Londër, prej më shumë se 25 vitesh.
47. Bashkëlidhur inventarit dokumentacioni si më poshtë:
48. Kopje nga sistemi Tims, për shtetasin Kujtim Gjoka, ku konfirmohen lëvizjet si më poshtë:
- Dalje datë 11.01.2020 (Hani i Hotit) - 11.01.2020 (Hani i Hotit).
  - Dalje datë 09.04.2022 (Rinas, British Airways, London) - Hyrje datë 15.04.2022 (Rinas, British Airways, London).
49. Kopje nga sistemi Tims për shtetasen Anduela Gjoka, ku konfirmohen lëvizjet, si më poshtë:
- Dalje datë 09.04.2022 (Rinas, British Airways, London) — Hyrje datë 15.04.2(022 (Rinas, British Airways, London).
50. Kopje nga sistemi Tims, për shtetasin Gjon Gjoka (nuk ka pasur lëvizje për periudhën).
51. Kopje nga sistemi Tims, për shtetasen Davë Gjoka (nuk ka pasur lëvizje për periudhën).
52. Kopje nga sistemi Tims, për shtetasin Enis Gjoka (nuk ka pasur lëvizje për periudhën).
53. Kopje nga sistemi Tims, për shtetasin Nikolas Gjoka (nuk ka pasur lëvizje për periudhën).
- ✓ *Shpenzimet e deklaruara për udhëtimet private, personale të subjektit dhe bashkëshortes, gjatë periudhës së sipërcituar, rezultojnë të deklaruara rreth 400 euro + 5.000 lekë, konvertuar rreth 50.000 lekë.*

C. Shpenzime për arsimin e fëmijëve, madhorë apo të mitur, apo të personave të lidhur, duke deklaruar fillimin, llojin e institucionit arsimor, emrin e institucionit, pagesat vjetore, si dhe kohëzgjatjen e studimeve, sipas periudhës së përcaktuar në nenin 32, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

54. Subjekti i vlerësimit ka deklaruar:

54.1 Shpenzime për pagesën e tarifës së studimit në Universitetin Politeknik të Tiranës Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, për djalit Enis Gjoka, për ciklin e studimeve Bachelor, nga tetor 2018 - korrik 2021. Për vitin e parë tarifa është 0 lekë, si student ekselent. Tarifa për vitin e dytë është në vlerën 50 % (nga pakti për universitetet), ne shumën 17.500 lekë. Tarifa e vitit të tretë është 35.000 lekë. Shuma 52.500 lekë.

54.2 Shpenzime për pagesën e shkollimit të djalit Enis Gjoka, në ciklin e dytë të studimeve Master në Universitetin Polis, për periudhën tetor 2021 - korrik 2023. Shuma 4.000 euro.

54.3 Shpenzime për shkollimin e djalit Nikolas Gjoka, në vitin shkollor 2022 - 2023, në Universitetin Aldent, dega fizioterapi. Shuma 2.071 euro.

55. Trupa e Vlerësimit mori në shqyrtim dokumentacionin bashkëlidhur deklaratës, ku rezulton se:

55.1 Referuar kontratës së regjistrimit, datë 28.10.2022, me palë Universiteti Aldent dhe studentin Nikolas Gjoka, me objekt regjistrimin e studentit për Bachelor në Fizioterapi, konfirmohet se tarifa e pagesës është në vlerën 2,300 euro, në vit.

55.2 Sipas mandat pagesës nga BKT, datë 03.11.2022, është kryer pagesë shkollimi në vlerën 2,071 euro, për Nikolas Gjoka, në favor të Universitetit Aldent.

55.3 Gjithashtu, mandatet e pagesave (6 mandate) nga Tirana Bank dhe Raiffeisen Bank, për periudhën 14.10.2021 - 23.02.2023, konfirmojnë pagesat në favor të Universitetit Polis, tarifa shkollimi për Enis Gjoka, në vlerën totale 180.000 lekë dhe 2.550 euro.

✓ Shpenzimet e deklaruara për arsimimin e fëmijëve gjatë periudhës deri në ditën e plotësimit të formularit të deklaramit të pasurisë rezultojnë në total 232.500 lekë + 4.621 euro, konvertuar rreth 746.000 lekë.

**DEKLARIMI I NËNËS - DAVË GJOKA**

**DEKLARIMI I PASURIVE**

56. **Shtëpi banimi** me sipërfaqe 156 m<sup>2</sup>, në zonën kadastrale \*\*\*, me numër pasurie \*\*\*\*\*, vol. \*\*, faqe \*\*\*, ishull Lezhë. Ndërtuar në vitin 2006 - 2007, me kursime familjare dhe kredi të

marrë nga nusja e djalit Anduela Gjoka, në BKT. Shtëpia i është nënshtruar procesit të legalizimit. Në kohën e ndërtimit ka kushtuar 3.150.000 lekë.

**Zotëron** 50 %.

57. Subjekti ka bashkëlidhur deklaratës:

58. Kontratë kredie bankare nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 26.03.2007, me palë kredi dhënëse BKT dhe kredi marrës A. Gj., dorëzanës K. Gj., M. Gj. dhe M. Gj., me objekt dhënie kredie bankare, në vlerën 3.000.000 lekë, për blerje shtëpie, me afat 240 muaj. Sigurimi i kredisë do të bëhet nëpërmjet hipotekimit të pasurisë truall + ndërtesë, me sipërfaqe 72 m<sup>2</sup> truall dhe 72 m<sup>2</sup> ndërtesë, me nr. \*\*\*\*, zk. \*\*\*, vol. \*\*, fq. \*\*, ndodhur në Ishull Lezhë.

59. Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 18.06.2019, për pasurinë me nr. \*\*\*, e llojit apartament, me sipërfaqe 156 m<sup>2</sup>, ndodhur në Ishull Lezhë, në emër të Davë dhe Gjon Gjoka. Bashkëlidhur harta treguese.

## HETIMI ADMINISTRATIV

60. ASHK, Drejtoria Vendore Lezhë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.01.2024, konfirmon në emër të Gjon dhe Davë Gjoka, pasurinë me nr. \*\*\*\*, zk. \*\*\*, e llojit apartament, me sipërfaqe 156 m<sup>2</sup>, e ndodhur në Ishull Lezhë, regjistruar në datë 14.06.2019, me kontratë dhurimi.

61. ASHK, Drejtoria Vendore Lezhë, me e-mailin e datës 05.03.2024, ka bashkëlidhur dokumentacionin, të cilin Trupa e Vlerësimit ka marrë në shqyrtim si më poshtë:

61.1 Vetë deklaram për legalizimin e objektit, datë 08.11.2006, Njesisë së Urbanistikës së Njesisë së Qeverisjes Vendore Lezhë, me objekt shtëpi banimi 2 kat, lagjja SMT Lezhë, me sipërfaqe ndërtimi 140 m<sup>2</sup>, me vetë deklarues Gj. Gj. dhe M. Gj.

61.2 Leje legalizimi nga Aluizni Lezhë, nr. 10231, datë 02.05.2012, për godinë banimi 2 kat, në emër të M. Gj. dhe Gj. Gj., me adresë Komuna, Shëngjin, Lezhë, zk. \*\*\*, numri i pasurisë \*\*\*, sipërfaqja e parcelës 235 m<sup>2</sup>, e ndërtimit 120.3 m<sup>2</sup>, totale për banim 291.15 m<sup>2</sup>.

61.3 Kartela e pasurisë së paluajtshme, për pasurinë me nr. \*\*\*, zk. \*\*\*, ndodhur në Lezhë, e llojit truall me sipërfaqe 332 m<sup>2</sup>, dhe 163 m<sup>2</sup>, në emër të M. Gj. dhe Gjon Gjoka. Pasuria ka shënimin "Leje legalizimi nr. \*\*\*, datë 02.05.2012, godinë banimi 2 kat, sipërfaqe katit përdhe 120.3 m<sup>2</sup>, nga e cila 72 m<sup>2</sup> e regjistruar, sipërfaqe kati i parë 156 m<sup>2</sup>.

61.4 Kontratë dhurimi nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 13.05.2019, me palë dhurues M. Gj dhe M. Gj., palë pranues i dhurimit Gjon dhe Davë Gjoka, me objekt dhurimin e 50% të pjesës takuese ideale të pandarë ose 78 m<sup>2</sup> të pasurisë me nr. \*\*\* vol. \*\*, fq. \*\*\*, zk. \*\*\*, me sipërfaqe 156 m<sup>2</sup>, e ndodhur në Ishull, Lezhë. Në këto kushte pranuesit e dhurimit Gj. Gj. dhe D. Gj., bëhen pronarë të 100 % të pasurisë së mësipërme.

- 61.5 Kontratë dhurimi nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 13.05.2019, me palë dhurues Gj. Gj. dhe D. Gj., palë pranues i dhurimit M. Gj. dhe M. Gj., me objekt dhurimin e 50 % të pjesës takuese ideale të pandarë ose  $24.15 m^2$ , të pasurisë me nr. \*\*\*\*, vol.\*\*, fq. \*\*, zk. \*\*\*, me sipërfaqe  $48.3 m^2$ , e ndodhur në Ishull, Lezhë. Në këto kushte, pranuesit e dhurimit M. Gj. dhe M. Gj., bëhen pronarë të 100% të pasurisë së mësipërme.
62. BKT, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.08.2023, konfirmon në emër të Anduela Gjoka, kredi në lekë, me gjendje detyrimi në datë 08.05.2023, në vlerën 972.203 lekë. Kredia rezulton e disbursuar në datën 29.03.2007, në vlerën 2.940.000 lekë. Për periudhën 02 – 03.04.2007 tërheq nga llogaria në total 2.910.000 lekë, me përshkrimin “Anduela Gjoka, tërheqje nga llogaria me kërkesë bashkëngjitur”.
63. OTP Bank, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.08.2023, konfirmon në emër të Anduela Gjoka, llogari në lekë, ku konfirmohet kredi e disbursuar në datën 26.02.2019 në vlerën 135.000 lekë. Llogaria rezulton e mbyllur.
64. ProCredit Bank, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.08.2023, konfirmon në emër të A. Gj. dhe K. Gj., depozitë në lekë, çelur në datë 16.02.2005 në vlerën 1.000.000 lekë, deri më datë 16.02.2006, ku tërhiqet nga llogaria vlera 1.022.700 lekë. Depozita dhe llogaria rezultojnë të mbyllura.
65. Credins Bank, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 04.10.2023, konfirmon në emër të K. Gj. depozitë në vlerën 1.100.000 lekë, në datë 18.08.2005, deri më datë 20.02.2006.
66. Me inventarin e datës 01.03.2024, subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues, si dhe sqarime me shkrim, ku sqaron se shtëpia e banimit me sipërfaqe  $156 m^2$ , në zonën kadastrale \*\*\*\*, Ishull Lezhë është ndërtuar në vitet 2006 dhe 2007. Punimet janë bërë nga subjekti, babai, punëtorë dhe mjeshtra jo të kualifikuar të kontaktuar personalisht dhe jo me një subjekt ndërtues. Bashkëlidhur kopje të disa faturave të blerjes së materialeve të ndërtimit. Shtëpia e banimit me sipërfaqe  $156 m^2$ , është ndërtuar si shtesë kati mbi objektin ekzistues, me sipërfaqe trualli  $72 m^2$  dhe sipërfaqe ndërtimi  $72 m^2$ , në zonën kadastrale \*\*\*, volumi \*\*, faqe \*\*, në pronësi të vjehrrit, vjehrrës dhe bashkëshortes A. Gj. Banesa përdoret për banim nga subjekti dhe familja e tij. Nga kredia e marrë nga bashkëshortja, në vlerën 3.000.000 lekë, janë përdorur konkretisht 1.027.300 lekë, për punime ndërtimi të kësaj shtëpie, si dhe 500.000 lekë, për mobilim. Lidhur me konfirmimin e OTP Bank, për një kredi të disbursuar në emër të A. Gj., në datën 26.02.2019, në vlerën 135.000 lekë, sqaron se kjo kredi është përdorur për blerjen e pajisjeve elektro-shtëpiake pas kësaj periudhe. Kjo kredi është shlyer sipas planit me këst mujor.
67. Lidhur me konfirmimin e ProCredit Bank, ku sqaron se kjo depozitë është krijuar nga kursimet familjare të tyre, që kanë ardhur nga pagat, shpërblimet, orët suplementare, taksa e solidaritetit etj. Sqaron se deri në vitin 2004, nëpërmjet dokumentave zyrtare vërteton vetëm marrjen e

pagës neto, por në vërtetimin e lëshuar nga DVP Lezhë, nuk është përfshirë asnjë nga përfitimet e tjera, si shpërblime, orë suplementare, taksa e solidaritetit që është marrë për një periudhë prej 4 vitesh, pasi nuk kanë dokumentacion të ruajtur. Në këtë depozitë përfshihen dërgesat e një sasi prej 600.000 lekë, nga motra Dh. Gj., e cila është emigrante në Greqi, që nga viti 1998. Sqaron se duke qenë se ka kaluar një periudhë e gjatë kohore, nuk mund të sigurojë dot dokumentacion në lidhje me punësimin në Greqi të motrës, për periudhën deri në vitin 2005. Kjo sasi lekësh u është dhënë prindërve të tij nga vajza e tyre ndër vite, nga 1999 deri në vitin 2005, në shuma të ndryshme. Për këtë sasi lekësh të dërguar nga ana e motrës paraqet një deklaratë noteriale të bërë nga ana e saj, në shtetin Grek. Këto para i janë dhënë nga prindërit për t'i depozituar. Destinacioni i përdorimit pas tërheqjes ka qenë për ndërtimin e shtëpisë. Në lidhje me depozitën në vlerën 1.100.000 lekë, në Credins Bank, sqaron se burimi i të ardhurave është nga kursimet familjare ndër vite, me të ardhurat e siguruar nga pagat e tij, bashkëshortes, babait dhe nënës. Sqaron se gjetja e dokumenteve para vitit 1994 është e vështirë, pasi ato janë shkatërruar gjatë trazirave të vitit 1997 dhe nuk kanë qenë të hedhura në sistemet e Sigurimeve Shoqërore. Pas tërheqjes, destinacioni i përdorimit të këtyre parave ka qenë për ndërtimin e shtëpisë së banimit të prindërve.

68. Subjekti ka bashkëlidhur inventarit dokumentacionin justifikues si më poshtë:

- Foto aktuale të banesës.
- Fatura të ndryshme ndërtimore (27 fatura), për periudhën 2006 - 2007, në vlerën totale rreth 1.090.000 lekë, fatura elektro-shtëpiake (3 fatura për periudhën 2007 - 2011 dhe një faturë në vitin 2022), në vlerën totale rreth 133.000 lekë.
- Deklaratë e thjeshtë, datë 19.02.2024, (e noterizuar në gjuhën Greke, me vulë Apostile), nga Dh. Gj., e cila deklaron se ka dërguar pranë familjes, konkretisht babait dhe nënës, nga viti 1999 deri në janar 2005, një shumë prej 600.000 lekë, nga kursimet e saj nga emigracioni në Greqi. Këto para i ka dërguar në shuma të ndryshme gjatë viteve dhe dorazi sa herë që ka ardhur në Shqipëri, ose nëpërmjet të njohurve të saj. Deklaron se jeton dhe punon në Greqi, nga viti 1998. Bashkëlidhur praktika.
- Dokumentacion (leje qëndrimi), në gjuhën Greke, për shtetasen Dh. Gj.

69. Me inventarin e datës 11.03.2024, subjekti ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

- Preventiv punimesh, përpiluar nga shoqëria \*\*\* shpk, për objekt banimi me adresë në Ishull Lezhë, në emër të Gjon dhe Davë Gjoka, me sipërfaqe 156 m<sup>2</sup>. Vlera e punimeve të ndërtimit të objektit është në shumën totale 3.148.655 lekë.

70. Bazuar në deklarinimin e subjektit, dokumentacionin e paraqitur, si dhe në korrespondencën e administruar, në mënyrë të përmbledhur rezulton se, *nëna e subjektit (dhe babai më poshtë) ka deklaruar se gjatë periudhës 2006 - 2007, kanë ndërtuar shtesë kati me sipërfaqe 156 m<sup>2</sup>, mbi objektin ekzistues, me sipërfaqe ndërtimi 72 m<sup>2</sup>, në pronësi të bashkëshortes së subjektit dhe të prindërve të saj, kryesisht vetë dhe me punëtorë ditorë. Vlera në kohën e ndërtimit ka qenë rreth 3.150.000 lekë, me burim një pjesë nga kredi bankare e marrë nga Anduela Gjoka, në*

vlerën 1.027.300 lekë dhe pjesa tjetër nga kurismet familjare, si dhe dërgesa nga motra e subjektit Dh. Gj., prindërve të saj, në vlerën totale 600.000 lekë. Gjithashtu janë shpenzuar rreth 635.000 lekë, për mobilimin e tij, me burim kredi bankare. Për objektin godinë 2 kate është aplikuar për legalizim në vitin 2006, nga babai i subjektit dhe babai i bashkëshortes, të cilët pas marrjes së lejes së legalizimit, me anë të kontratave të dhurimit, kanë ndarë pjesët e tyre takuese, konkretisht kati përdhe i përket prindërve të bashkëshortes dhe kati i parë prindërve të subjektit.

- ✓ **Lidhur me burimin financiar të përdorur për ndërtimin e objektit, subjekti ka dhënë sqarime dhe ka paraqitur dokumentacion, si dhe një preventiv punimesh nga shoqëri e licencuar, ku evidentohet se kosto e ndërtimit ka qenë në vlerën rreth 3.150.000 lekë.**
- ✓ **Ndërtimi i objektit me sipërfaqe 156 m<sup>2</sup>, ka pasur si burim edhe të ardhurat e motrës Dh. Gj. nga emigracioni në Greqi, në vlerën 600.000 lekë, dërguar prindërve të saj, për periudhën 1999 - 2005, për të cilat mungon dokumentacioni justifikues ligjor, rrjedhimisht është i aplikueshëm neni 32, pika 1.1 e Ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.**

## DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

71. Të ardhura nga pensionet e mia nga data 01.10.1997 deri në shkurt 2023. Vlera 3.646.633 lekë.
  72. Subjekti ka bashkëlidhur deklaratës vërtetim nga ISSH, datë 09.03.2023, ku vërteton se Davë Gjoka, përfiton pension pleqërie, për periudhën nëntor 1994 - shkurt 2023, në vlerën totale rreth 3.760.000 lekë.
  73. ISSH, me shkresën nr. \*\* prot., datë 14.08.2023, konfirmon se Davë Gjoka, përfiton pension pleqërie në masën 20.428 lekë, nga tetor 1994.
  74. ISSH Drejtoria e Arkivit Qendror, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 24.08.2023, ka bashkëlidhur vërtetime për vjetërsinë në punë, për shtetasen Davë Gjoka, periudha e punës 1980-1991.
  75. Trupa e Vlerësimit mori në shqyrtim dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti më datë 01.03.2024, konkretisht vërtetim nga ISSH, datë 16.04.2018, për të ardhurat e Davë Gjoka, nga pensioni për periudhën 1994 - 2018.
- ✓ **Në përfundim të hetimit rezulton se të ardhurat e nënës, për periudhën 1994 - 2023, janë në total rreth 3.750.000 lekë.**

## DEKLARIMI I BABAIT-GJON GJOKA

## DEKLARIMI I PASURIVE

76. **Shtëpi banimi me sipërfaqe 156 m<sup>2</sup>**, në zonën kadastrale \*\*\* me numër pasurie \*\*\*\*, vol. \*\*, faqe \*\*\*, ishull Lezhë. Ndërtuar në vitin 2006 - 2007, me kursime familjare dhe kredi, të marrë nga nusja e djalit Anduela Gjoka në BKT. Shtëpia i është nënshtruar procesit të legalizimit. Në kohën e ndërtimit ka kushtuar **3.150.000 lekë**.  
**Zotëron** 50%.

✓ **Trajtuar më lart.**

77. **Shtëpi banimi** në fshatin Kaçinar Mirditë, me sipërfaqe 59 m<sup>2</sup>, e ndërtuar në vitin \*\*\*\*, nga kursimet e mia familjare dhe trualli mbi të cilin është ndërtuar shtëpia me sipërfaqe 300 m<sup>2</sup>, zk. \*\*\*, nr. pasurisë \*\*\*, vol. \*\*, fq. \*\*\*.  
**Vlera** e papërcaktuar.  
**Zotëron** 100%.

78. Subjekti ka bashkëlidhur deklaratës certifikatë për vërtetim pronësie, datë 12.03.2012, për pasurinë me nr. \*\*\*, zk. \*\*\*, ndodhur në Mirditë, Kaçinar, me sipërfaqe trualli 300 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë 59 m<sup>2</sup>, në emër të Gjon Gjoka. Bashkëlidhur harta treguese.

79. ASHK Zyra Vendore Mirditë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.10.2023, nuk konfirmon pasuri në emër të subjektit apo personave të lidhur.

80. Me inventarin e datës 01.03.2024, subjekti ka dorëzuar dokumentacion justifikues, si dhe sqarime me shkrim, ku sqaron se kjo pasuri është ndërtuar në vitin 1978, në fshatin Kaçinar, Mirditë, për të cilën nuk mund të japë një vlerë ekonomike, duke qenë se në atë periudhë ka qenë i mitur dhe i përket një regjimi tjetër ekonomik. Nuk disponojnë dokumente për ndërtimin. Trualli ka qenë shtetëror në kohën e ndërtimit të saj dhe në bazë të legjislacionit në fuqi të asaj kohe, çdo shtëpi gëzonte të drejtën e 300 m<sup>2</sup> truall. Gjatë 30 viteve të fundit, për këtë shtëpi nuk është shpenzuar asnjë vlerë monetare. Mobilimi i kësaj shtëpie, i përket periudhës para viteve 1990. Si shtëpi fshati, sot ajo përdoret më së shumti nga prindërit e tij në periudhën e verës. Pjesën më të madhe të vitit qëndron e mbyllur.

81. Me inventarin e datës 01.03.2024, subjekti ka dorëzuar foto aktuale të objektit, nga ku evidentohet se objekti është një ndërtim i vjetër, ashtu sikurse ka deklaruar subjekti.

✓ **Në përfundim të verifikimeve dhe kontrollit të kryer, rezulton se konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe sqarimet përkatëse.**

## **DEKLARIMI I TË ARDHURAVE**

82. Të ardhura nga paga si mësues dhe nga pensioni, nga data 01.10.1997, deri në shkurt 2023.  
Vlera 6.608.798 lekë.

83. Bashkëlidhur deklaratës:



- Vërtetim nga ISSH, datë 09.03.2023, ku vërtetohet se Gjon Gjoka, përfiton pension pleqërie, për periudhën shkurt 2009 - shkurt 2023, në vlerën totale rreth 4.332.000 lekë.
  - Vërtetime mbi bazën e lërueshëm nga ISSH, ku konfirmon pagat neto të Gj. Gj., për periudhën 1994 - 2008, në vlerën totale rreth 2.596.000 lekë.
84. ISSH, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.08.2023, konfirmon se Gj. Gj., përfiton pension pleqërie në masën 32.144 lekë, nga shkurt 2009.
85. ISSH, Drejtoria e Arkivit Qendror, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 24.08.2023, ka bashkëlidhur vërtetime për vjetërsinë në punë, për shtetasin Gjon Gjoka, periudha e punës 1968-1990.
86. ProCredit Bank, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.08.2023, konfirmon në emër të Gj. Gj., llogari rrjedhëse në lekë, ku konfirmohen kreditimet nga paga për periudhën 05.07.2005 - 04.03.2009, në vlerën totale rreth 1.027.000 lekë.
87. Me inventarin e datës 01.03.2024, subjekti ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:
- Vërtetim mbi bazën e vlerësueshme nga ISSH, ku konfirmon pagat neto të Gjon Gjoka për periudhën janar 1994 - dhjetor 1997, në vlerën totale 334.116 lekë.
  - Vërtetim nga ISSH, datë 17.04.2018, ku vërtetohet se Gjon Gjoka ka qenë në marrëdhënie pune për periudhën janar 1968 - maj 1990.
- ✓ **Nga kontrolli dhe verifikimi i kryer nga Trupa e Vlerësimit, rezultojnë se të ardhurat e babait të subjektit, për periudhën 1994 - 2023, janë në vlerën totale rreth 7.000.000 lekë.**

## DEKLARIMI I BASHKËSHORTES-ANDUELA GJOKA

### DEKLARIMI I PASURIVE

88. **Ndërtesë me sipërfaqe 88.65 m<sup>2</sup>** dhe trualli me sipërfaqe 240 m<sup>2</sup>. Fitimi i pronësisë me lejen e legalizimit nr. \*\*\*\*\*, datë 28.06.2018. Ndërtuar në vite, me kursime familjare.  
**Vlera** 1.800.000 lekë.  
**Zotëron** 50 %.
- ✓ **Trajtuar më lart.**
89. **Shtëpi banimi** në zonën kadastrale 1986, ishull Lezhë, me sipërfaqe 72 m<sup>2</sup> dhe trualli 72 m<sup>2</sup>. **Burimi i krijimit**, privatizuar nga Enti i Banesave, në datë 08.11.1993, me kontratën e datës 08.11.1993 me Entin e Banesave. Kontrata noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 02.03.2000.  
**Vlera** 29.739 lekë.  
**Zotëron** 1/3 pjesë.

90. Bashkëlidhur deklaratës:

- Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 25.01.2007, për pasurinë me nr. \*\*\*, vol. \*\*, fq. \*\*, e llojit truall, me sipërfaqe 72 m<sup>2</sup>, ndërtesë 72 m<sup>2</sup>, e ndodhur në Ishull Lezhë, në emër të M. Gj., M. Gj. dhe A. Gj. Bashkëlidhur praktika.
- Kontratë për privatizimin e banesës, datë 08.11.1993, ndërmjet NK Banesa dhe qiramarrësit M. Gj., për apartament, kati përdhe, përbërë nga dy dhoma një kuzhinë, ndërtuar në vitin 1970, në vlerën 29.739 lekë.
- Akt shitblerje prone, nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 02.03.2000, me palë shitëse Ndërmarrje Komunale Banesa Lezhë dhe blerës M. Gj., M. Gj. dhe A. Gj., për apartament me sipërfaqe 72 m<sup>2</sup>, në vlerën 29.739 lekë. Bashkëlidhur praktika.

91. ASHK Drejtoria Vendore Lezhë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.01.2024, nuk e konfirmon pasurinë e deklaruar nga bashkëshortja.

✓ **Në përfundim të kontrollit dhe verifikimit mbi bazë dokumentacioni të kryer nga Trupa e Vlerësimit, konstatohet se përputhet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar.**

92. **Llogari kursimi në BKT** nga kursimet personale e familjare me nr. \*\*\*\*\*, e krijuar më datë 01.10.2016.

**Vlera** 267.562 lekë.

**Zotëron** 100 %.

93. Trupa e Vlerësimit mori në shqyrtim dokumentacionin e përcjellë nga subjekti, nga ku rezulton se:

94. Referuar nxjerrjes së llogarisë bankare nga BKT, datë 15.02.2023, konfirmohet llogari në lekë, në emër të Anduela Gjoka, për periudhën 20.12.2016 - 30.12.2022.

95. Sipas mandat pagesës nga BKT, datë 09.03.2020, konfirmohet se Anduela Gjoka kalon në llogari kursimi vlerën 116.000 lekë.

96. BKT, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.08.2023, konfirmon në emër të Anduela Gjoka, llogari kursimi në lekë, me gjendje në datë 08.05.2023, në vlerën 268.067 lekë, si dhe llogari rrjedhëse në lekë, me gjendje 332 lekë.

✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e BKT.**

97. **Llogari bankare** për kalimin e pagës në Tirana Bank, krijuar në dhjetor 2020. Gjendja në llogari paga + overdraft, ofruar nga banka në datën 27.04.2023 është 200.197 lekë. Overdraft 200.000 lekë, nga paga 197 lekë.

**Zotëron** 100 %.

98. Subjekti ka bashkëlidhur deklaratës së bashkëshortes nxjerrje llogarie bankare nga Tirana Bank, për llogari në lekë, në emër të Anduela Gjoka, për periudhën 24.12.2020 - 04.01.2023.

99. Tirana Bank, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.08.2023, konfirmon në emër të Anduela Gjoka, llogari page në lekë, me gjendje në datë 08.05.2023, në vlerën 28.288 lekë.

✓ **Konfirmohet llogaria e pagës, me gjendje në datë 08.05.2023, në vlerën 28.288 lekë. Subjekti i referohet në deklarin datës 27.4.2023. Nuk konfirmohet përdorim overdrafti.**

## **DEKLARIMI I TË ARDHURAVE**

100. Të ardhura nga paga si punonjëse e \*\*\*\*\*, Njësia Lezhë, nga data 16.10.1998, e në vazhdim deri aktualisht. Shuma 14.058.957 lekë.

101. Të ardhura nga kompesimi për dëmtimet nga tërmeti i vitit 2019 në banesë, të derdhura në llogarinë e kredisë, e më pas nga vetë unë janë kaluar në llogarinë e kursimit, nga Sigal Uniq Group sha, në datë 21.01.2020. Vlera 116.321 lekë.

102. Bashkëlidhur deklaratës:

- Vërtetim nga \*\*\*\*, datë 19.04.2018, ku vërteton se Anduela Gjoka, është e punësuar nga data 16.10.1998 e aktualisht, dhe gjatë kësaj periudhe ka realizuar të ardhura neto në vlerën totale 8.657.845 lekë.
- Statement nga BKT, datë 15.02.2023, për llogari në lekë, në emër të Anduela Gjoka, për periudhën 03.05.2018 - 01.12.2020.
- Statement nga Tirana Bank, për llogari në lekë, në emër të Anduela Gjoka, për periudhën 24.12.2020 - 04.01.2023.
- Statement nga BKT, datë 15.02.2023, për llogari në lekë, në emër të Anduela Gjoka, për periudhën 10.05.2018 - 13.02.2023.
- Stetement nga BKT, datë 17.04.2018, për llogari në lekë, në emër të Anduela Gjoka, për periudhën 29.03.2007 - 11.04.2018.

103. BKT, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.08.2023, konfirmon në emër të Anduela Gjoka, llogari në lekë, ku konfirmohen kreditimet nga paga, për periudhën shkurt 2015 - nëntor 2020, në vlerën totale rreth 4.955.000 lekë. Për periudhën prill 2018 - nëntor 2020, ka përfituar të ardhura në vlerën totale, rreth 2.467.000 lekë.

104. Tirana Bank, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.08.2023, konfirmon në emër të Anduela Gjoka, llogari në lekë, ku konfirmohen kreditimet nga paga për periudhën dhjetor 2020-maj 2023, në vlerën totale rreth 3.143.000 lekë.

- ✓ *Në përfundim të verifikimeve dhe kontrollit të kryer, rezulton se të ardhurat e bashkëshortes, për periudhën tetor 1998 - maj 2023, janë në vlerën totale rreth 14.268.000 lekë.*

## DETYRIME FINANCIARE

105. **Kredi** për ndërtim shtëpie e marrë në BKT, dega Lezhë, me afat 20 vjeçar në shumën 3.000.000 lekë, e disbursuar në datën 29.03.2007. Kësti mujor ka qenë i ndryshueshëm në bazë të përqindjes së bonove të thesarit. **Vlera** 990.161 lekë.

106. **BKT**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.08.2023, konfirmon në emër të Anduela Gjoka, kredi në lekë, me gjendje detyrimi në datë 08.05.2023, në vlerën 972.203 lekë.

107. Trupa e Vlerësimit mori në shqyrtim dokumentacionin bashkëlidhur deklaratës, konkretisht aneks i planit të pagesës nga BKT, datë 15.02.2023, për kredi bankare, në emër të Anduela Gjoka, për periudhën 04.01.2023 deri më datë 04.12.2023; ashtu sikurse dhe pagesat e kryera në llogarinë pranë BKT Bank. (Bashkëlidhur praktika).

108. Trupa e Vlerësimit, kreu analizën financiare mbi mundësinë e shlyerjes së kredisë së marrë, duke llogaritur për çdo vit të ardhurat nga punësimi dhe shpërblimet të subjektit të vlerësimit dhe bashkëshortes së tij, shpenzimet jetike sipas INSTAT dhe shpenzimet për pagesë kredie (principal + interesa).

109. *Në përfundim të hetimit të kryer, rezulton se konfirmohet deklarami me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e BKT, si dhe kanë pasur mundësi për të shlyer kredinë e marrë.*

## DEKLARIMI I DJALIT - ENIS GJOKA

### DEKLARIMI I PASURIVE

110. **Autoveturë e markës Audi A3**, me targa AB\*\*\*N blerë në datën 12.03.2022, me të ardhurat e shitjes së automjetit tip VW Passat me targa AA\*\*\*\*O, në pronësi të babait Kujtim Gjoka. Shitur në datë 17.12.2022 në shumën 4.000 euro, me kontratë nr. \*\*\*\*, nr. koleksioni \*\*\*, datë 17.12.2022. Shuma **3.000 euro**. Zotëron **100%**.

111. Bashkëlidhur deklaratës kontratat e shitblerjes së automjetit të deklaruar më sipër.

112. **DPSHTRR**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.11.2023, konfirmon se shtetasi Enis Gjoka ka pasur të regjistruar mjetin me targë AB\*\*\*N. Bashkëlidhur dokumentacioni si më poshtë:

- Kontratë shitblerje nr. \*\*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 07.12.2022, me palë shitëse Enis Gjoka dhe blerës E. H., për automjet tip Audi, targa AB\*\*\*N, viti 2008, në vlerën 4.000 euro.

- Kontratë shitblerje nr. \*\*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 12.03.2022, me palë shitëse M. D. dhe blerës Enis Gjoka, për automjetin me targë AA\*\*\*\*N, në vlerën 3.000 euro.

✓ *Nga verifikimi dhe kontrolli i kryer, rezulton se konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR.*

✓ *Djali Enis Gjoka ka pasur burime financiare të mjaftueshme për krijimin e kësaj pasurie të luajtshme.*

113. **Autoveturë e markës BMW**, me targa AB\*\*\*\*M, blerë më datë 19.12.2022, me të ardhurat e shitjes së automjetit tip Audi A3, me targa AB\*\*\*\*N dhe pjesën tjetër nga kursimet e pagës sime. Vlera **5.000 euro**. Zotëron **100 %**.

114. Bashkëlidhur deklaratës kontrata e shitblerjes, datë 19.12.2022.

115. DPSHTRR, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.11.2023, konfirmon se shtetasi Enis Gjoka ka të regjistruar mjetin me targë AB\*\*\*\*M. Bashkëlidhur praktika.

116. Referuar kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*\* rep., nr. \*\* kol., datë 19.12.2022, pala shitëse E. Ll. i ka shitur palës blerëse Enis Gjoka, automjet tip BMW, viti 2010, me targa AB\*\*\*\*M, në vlerën 5.000 euro. Bashkëlidhur praktika.

117. Në lidhje burimin e krijimit të automjetit të sipërcituar, Trupa e Vlerësimit mori në shqyrtim të ardhurat nga shitja e **autoveturës së markës Audi A3**, me targa AB\*\*\*\*N në vlerën 4.000 euro, si dhe **kursimet** e djalit në vlerë 1.000 euro.

118. Lidhur të ardhurat nga shitja e pasurisë së luajtshme me një vlerë më të lartë sesa çmimi i blerjes, konkretisht me një diferencë prej 1.000 euro (4.000 euro - 3.000 euro), subjekti i vlerësimit përcolli pranë Trupës së Vlerësimit sqarime me shkrim se, djali Enis Gjoka, më datë 11.10.2022, në automjetin Audi A3 me targa AB\*\*\*\*N, ka bërë shërbime në vlerën prej 127.000 lekë.

- Bashkëlidhur kopje të faturës tatimore të shërbimeve të kryera më datë 11.10.2022, pranë \*\*\*\*\*.

119. Në këto rrethana, të kryerjes së shërbimeve dhe investimeve në automjetin me targa AB\*\*\*\*N që ka shërbyer për blerjen e **autoveturës tip BMW**, me targa AB\*\*\*\*M, (*justifikuar me dokument ligjor në kohën e kryerjes së shërbimeve*), rezulton se vlera e automjetit është rritur dhe ka shkuar në shumën që është shitur më datë 17.12.2022.

120. Trupa e Vlerësimit, pas verifikimeve të kryera, si dhe pas kryerjes së analizës financiare mbi mundësinë për kursim në vlerën 1.000 euro të djalit Enis Gjoka, arriti në konkluzionin se;

✓ *Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e DPSHTRR.*

✓ *Djali Enis Gjoka ka pasur burime të ligjshme financiare për krijimin e kësaj pasurie të luajtshme.*

121. **Llogari bankare në BKT**, ku janë kaluar pagat nga punëdhënësi Bashkia Malësi e Madhe dhe Resort \*\*\*, e gjendje aktuale në datën 27.04.2023,  
**Vlera:** minus 30.000 lekë.  
**Zotëron** 100 %.
122. BKT, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.08.2023, konfirmon në emër të Enis Gjoka, llogari rrjedhëse në lekë, me gjendje në datë 08.05.2023, në vlerën 13.020 lekë.
- ✓ **Konfirmohet llogaria rrjedhëse në emër të Enis Gjoka, me gjendje në datë 08.05.2023, në vlerën 13.020 lekë. Djali Enis Gjoka i referohet në deklaram datës 27.04.2023.**
123. **Llogari bankare në Credins Bank**, ku janë kaluar pagat e punëdhënësit \*\*\*\*\* Resort, Twin Tower, me gjendje në llogari në datën 27.04.2023.  
**Vlera** 0 lekë.  
**Zotëron** 100%.
124. Subjekti ka bashkëlidhur deklaratës së djalit statement nga Credins Bank, ku konfirmohet llogaria në lekë, në emër të Enis Gjoka, për periudhën 18.01.2013 - 31.01.2023 dhe të ardhurat e deklaruara nga punësimi.
125. **Credins Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 04.10.2023, konfirmon në emër të Enis Gjoka, llogari page në lekë, me gjendje në vlerën -544 lekë.
- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Credins Bank.**
126. **Llogari bankare karta e studentit** në Credins Bank, në të cilën janë kryer derdhje nga llogaritë e tjera, nëpërmjet e-banking nga vetë unë, me gjendje në llogari në datën 27.04.2023.  
**Vlera** 100 lekë.  
**Zotëron** 100%.
127. Credins Bank, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 04.10.2023, konfirmon në emër të Enis Gjoka, llogari Visa Prepaid Student, në lekë, me gjendje në datë 08.05.2023, në vlerën 120 lekë.
- ✓ **Në përfundim të hetimit të kryer nga Trupa e Vlerësimit, konfirmohet deklarimi me të gjithë dokumentacionin e marrë në shqyrtim.**
128. **Depozitë kaltra në Credins Bank** e çelur nga prindërit e mi që në moshë minore, të cilën e administroj unë. Krijuar nga kursimet familjare të prindërve.  
**Vlera** 393.870 lekë.  
**Zotëron** 100%.

129. Bashkëlidhur deklaratës nxjerrja e llogarisë bankare nga Credins Bank, për llogari në lekë, në emër të Enis Gjoka, për periudhën 18.01.2013 - 31.01.2023.

130. Credins Bank, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 04.10.2023, konfirmon në emër të Enis Gjoka, depozitë në lekë, me gjendje në datë 08.05.2023, në vlerën 393.953 lekë.

131. Konfirmohen kreditime në llogari, për periudhën janar 2013 - shtator 2022, nga Anduela Gjoka në total 395.000 lekë.

132. Trupa e Vlerësimit, pas të verifikimeve dhe kontrollit të dokumentacionit, kreu analizën financiare mbi mundësinë për krijim të llogarisë së deklaruar nga djali Enis Gjoka, nga ku rezultoi se:

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Credins Bank.**
- ✓ **Kanë patur mundësi financiare për të krijuar llogarinë në lekë pranë Credins Bank.**

## **DEKLARIMI I TË ARDHURAVE**

133. Të ardhura nga paga në Bashkinë Malësi e Madhe, në studio projektimi \*\*\* shpk, \*\*\* Resort, \*\*\*\* Resort, dhe \*\*\*\* Resort. Vlera 1.001.377 lekë.

134. Të ardhura nga shitja e automjetit tip Audi A3, me targa AA\*\*\*N. Vlera 1.000 euro. *(trajtuar më sipër)*

## **HETIMI ADMINSTRATIV**

135. Subjekti ka bashkëlidhur deklaratës së pasurisë së djalit, vërtetimin mbi bazën e vlerësueshme nga ISSH, datë 11.02.2023, ku konfirmon pagën bruto të Enis Gjoka, për periudhën 2018-2023.

136. ISSH, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.08.2023, konfirmon pagat neto të Enis Gjoka, për periudhën korrik 2018 - korrik 2023, nga \*\*\*\*\* Resort, Hotel \*\*\*\*, Bashkia Malësi e Madhe.

137. Credins Bank, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 04.10.2023, konfirmon në emër të Enis Gjoka, llogari në lekë, ku konfirmohen kreditimet nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, \*\*\*Resort, Hotel \*\*\*\* dhe \*\*\*\* shpk, për periudhën shkurt 2019 - tetor 2022, në vlerën totale rreth 370.852 lekë.

138. BKT, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.08.2023, konfirmon në emër të Enis Gjoka, llogari në lekë, ku konfirmohen kreditimet nga \*\*\* shpk, Bashkia Malësi e Madhe, për periudhën gusht 2018 - maj 2023, në vlerën totale rreth 749.000 lekë.

- ✓ **Të ardhurat e Enis Gjoka, për periudhën shkurt 2019 - maj 2023, janë në vlerën totale rreth 1.120.000 lekë.**

## TË DHËNA KONFIDENCIALE

139. **Autoveturë tip Land Rover, Range Rover, me targa AB\*\*\*\*P në përdorim** sipas kontratës së përdorimit të lëshuar nga pronari i mjetit shtetasi B. Gj.. nr. rep. \*\*\* kol. \*\*\*, datë 07.03.2022.

140. Subjekti ka bashkëlidhur prokurën e posaçme nr. \*\*\* rep, nr. \*\*\* kol, datë 07.03.2022, me palë të përfaqësuar B. Gj., i cili emëron si përfaqësues Enis Gjoka, që të përdorë brenda dhe jashtë vendit automjetin me targa AB\*\*\*\*P, tip Range Rover, si dhe të hyjë në marrëveshje për shitjen e mjetit, të caktojë çmimin e shitjes, duke i dhënë të drejtën ta kthejë në pronësi të tij.

141. DPSHTRR, me shkresën nr. \*\*\*\* prot., datë 22.11.2023, konfirmon se shtetasi Enis Gjoka ka të regjistruar mjetin me targë AB\*\*\*\*M dhe ka pasur të regjistruar mjetin me targë AB\*\*\*\*N.

142. Me inventarin e datës 01.03.3034, si dhe në prapësimet e tij më shkrim drejtuar Relatores së çështjes më datë 03.10.2024, subjekti sqaron se për kontratën e përdorimit të mjetit tip Land Rover, Range Rover, me targa AB\*\*\*\*P, djali i tij me shtetasin B. Gj., banues në Ishull Lezhë, janë shokë fëmijërie, miq shumë të ngushtë, rritur bashkë dhe gjatë kohës që miku i tij nuk është në Shqipëri të ketë mundësinë për t'ju shërbyer me makinë prindërve të tij, për shkak të pamundësisë për ti dhënë vetë. Po ashtu i ka lënë të drejtën e kryerjes së procedurave të shitjes së mjetit (nëse jepet rasti) gjatë kohës që B. Gj. mund të jetë jashtë shtetit.

143. Gjithashtu, subjekti ka dhënë sqarime të mëtejshme dhe ka bashkëlidhur kontratën e shitblerjes së mjetit nga ana e z. B. Gj, si edhe dokumentacion justifikues mbi mundësinë për krijimin e kësaj pasurie nga ana e tij.

144. **Trupa e Vlerësimit, nga dokumentacioni i administruar dhe shpjegimet e subjektit, arrin në konkluzionin se, përputhet deklarimi me dokumentacionin e pasurisë së luajtshme të z. B. Gj., e cila është në përdorim të djalit të subjektit, z. Enis Gjoka.**

## DEKLARIMI I DJALIT - NIKOLAS GJOKA

### DEKLARIMI I PASURIVE

145. **Numër llogari bankare** në Credins Bank, ku kanë kaluar pagat e mia për punën sezonale pranë subjektit T\*\*\* T\*\*\*.

**Vlera** 865 lekë.

**Zotëron** 100 %.

146. Bashkëlidhur deklaratës: Statement nga Credins Bank, për llogari në lekë, në emër të Nikolas Gjoka, për periudhën 18.01.2013 - 30.05.2022.



147. Credins Bank, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 04.10.2023, konfirmon në emër të Nikolas Gjoka, llogari Visa Prepaid Student, në lekë, me gjendje në datë 08.05.2023, në vlerën 41 lekë.

✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Credins Bank.**

148. **Depozitë kaltra në Credins Bank**, e krijuar nga prindërit e mi, në të cilën kanë derdhur kursimet e tyre ndër vite në emrin tim.

**Vlera** 429.146 lekë.

**Zotëron** 100%.

149. Bashkëlidhur deklaratës:

- Statement nga Credins Bank, për llogari në lekë, në emër të Nikolas Gjoka, për periudhën 18.01.2013 - 30.05.2022.

150. Credins Bank, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 04.10.2023, konfirmon në emër të Nikolas Gjoka, depozitë në lekë, me gjendje në datë 08.05.2023, në vlerën 429.146 lekë.

151. Nga verifikimet e kryera, konfirmohen kreditime në llogari për periudhën janar 2013 - shtator 2022, nga Anduela Gjoka, në total 400.000 lekë.

152. Trupa e Vlerësimit, pas të verifikimeve dhe kontrollit të dokumentacionit, kreu analizën financiare mbi mundësinë për krijim të llogarisë së deklaruar nga djali Nikolas Gjoka, nga ku rezultoi se:

✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Credins Bank.**

✓ **Subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë pasur mundësi financiare për të krijuar depozitën në lekë të djalit të tyre Nikolas Gjoka.**

153. **Numër llogarie në BKT**, ku kanë kaluar pagat e mia për punën sezonale nga subjekti \*\*\*\* Resort. Aktualisht nuk kam gjendje në llogari.

**Vlera** 0 lekë.

**Zotëron** 100 %.

154. BKT, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.08.2023, konfirmon në emër të Nikolas Gjoka, llogari rrjedhëse në lekë, me gjendje në vlerën 0 lekë.

155. Nga verifikimi i statement bankar në Bankën BKT, rezulton se janë kredituar pagesa nga \*\*\*\* Resort në llogarinë në lekë në emër të Nikolas Gjoka.

✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e administruar.**

**DEKLARIMIT TË ARDHURAVE**

156. Të ardhura nga paga ime gjatë sezoneve të verës në subjektin T. T. dhe \*\*\* Resort. Vlera 106.818 lekë.
157. Referuar vërtetimit mbi bazën e vlerësueshme nga ISSH, datë 11.02.2023, Trupa e Vlerësimit konfirmon pagën bruto të Nikolas Gjoka, për periudhën 2021 - 2022.
158. ISSH, me shkresën nr. \*\*\*\* prot., datë 14.08.2023, konfirmon pagat neto të Nikolas Gjoka, për periudhën korik 2021 - gusht 2022, nga Hotel T. T. dhe \*\*\*\*.
159. Credins Bank, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 04.10.2023, konfirmon në emër të Nikolas Gjoka, llogari në lekë, ku konfirmohen kreditimet nga Hotel T. T., për periudhën gusht - shtator 2021, në vlerën totale 32.694 lekë.
160. BKT, me shkresën nr. \*\*\*\* prot., datë 22.08.2023, konfirmon në emër të Nikolas Gjoka, llogari në lekë, ku konfirmohen kreditimet nga \*\*\*\* shpk, për periudhën korrik - shtator 2022, në vlerën totale rreth 66.800 lekë.
- ✓ **Në përfundim të hetimit të kryer, rezulton se të ardhurat e Nikolas Gjoka, për periudhën gusht 2021 - shtator 2022, janë në vlerën totale rreth 100.000 lekë.**

#### **REZULTATE TË TJERA GJATË HETIMIT ADMINISTRATIV TË KRYER:**

161. Në Deklaratën e Pasurisë për vlerësim kalimtar, Kujtim Gjoka ka deklaruar adresën e plotë, ku është i regjistruar në Gjendje Civile: Lagjja “Besëlidhja” Lezhë, si dhe adresën: Rruga “Vëllezrit Coku”, Ishull Lezhë.
162. Me inventarin e datës 01.03.2024, subjekti ka dorëzuar sqarime me shkrim, ku sqaron se adresa e deklaruar, Lagjja Beslidhja Lezhë, është adresa e gjendjes civile, ndërsa adresa rruga “Vëllezërit Coku”, Ishull Lezhë, është adresa ku banon me familjen e tij.
163. Subjekti ka dhënë sqarime dhe ka paraqitur dokumentacion, lidhur me adresat e deklaruara nga ana e tij. Me inventarin e datës 11.03.2024, subjekti ka paraqitur certifikatë personale datë 08.03.2024, në emër të Kujtim Gjoka, me vendbanim në lagjen Beslidhja, Lezhë. Adresa e banimit i përket objektit ku subjekti jeton me familjarët e tij, trajtuar më lart.
164. Banka e Shqipërisë, Raiffeisen Bank, BKT, Intesa Sanpaolo Bank, Tirana Bank, Banka e Bashkuar e Shqipërisë, Banka e Parë e Investimeve, Banka Amerikane e Investimeve, Credins Bank, Union Bank, OTP Bank, Raiffeisen Leasing, Porsche Leasing, Albania Leasing, Landeslease, RFZ Invest, Credins Invest, Unioni Financiar Tiranë, AK Invest, Easypay, Fondi BESA, Institucioni Financiar NOA, Iutecredit Albania, Kredo Financë, konfirmojnë se subjekti dhe/ose personat e lidhur me të, nuk janë klientë të tyre, ç’ka konfirmohet me deklarin.

165. Drejtoritë dhe Zyrat Vendore të ASHK-së, dhe konkretisht: Tiranë Jug, Tiranë Rurale 2; Tiranë Rurale 1; Tiranë Veri; Kurbin; Vlorë; Korçë; Shkodër; Fier; Berat; Gjirokastër; Pogradec; Kamëz-Vorë; Lushnje; Kuçovë; Malësi e Madhe; Gramsh; Kavajë; Elbasan; Kolonjë; Has; Skrapar; Kukës; Durrës; Tropojë; Bulqizë; Pukë; Peqin; Mirditë; Tepelenë; Përmet; Krujë; Devoll; Zonat e Stimuluara; Librazhd; Mat; Dibër; Mallakastër; Sarandë; nuk konfirmojnë pasuri të paluajtshme të regjistruara apo në proces legalizimi në emër të subjektit dhe personave të lidhur.

166. **Abi Bank**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 15.08.2023, konfirmon në emër të Kujtim Gjoka, llogari në euro, ku rezulton një kreditim në vlerën 2.990 euro, në datë 20.09.2006 e cila është tërhequr. Llogaria rezulton e mbyllur.

*166.1 Subjekti ka dhënë sqarime me shkrim pranë trupës së Vlerësimit se, në këtë llogari bankare janë dërguar nga z. F. Z. Gj. që jeton e punon në Greqi prej shumë vitesh shuma prej 2990 euro. Lidhja tij me është farefisnore. Qëllimi i pagesës nga ana e tij është bërë për t'ia dërguar të vëllait z. A. Gjoka i cili jeton në fshatin Grykë Lumi të Lezhës, ku kujdesej për prindërit dhe shtëpinë. Arsyeja përse i është dërguar z. Gjoka, është për shpejtësi dhe fakti që posedoja një llogari në bankë greke në atë kohë.*

167. **Unioni Financiar** Tiranë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.08.2023, konfirmon një tërheqje nga Nikolas Gjoka, në vlerën 50.59 euro.

*167.1 Subjekti në prapsimet e tij, datë 02.10.2024, ka dhënë sqarime me shkrim se kjo shumë është dërguar nga Anglia nga z. I. M., në emrin e djalit Nikolas Gjoka. Ata janë shokë me njëri tjetrin. Dërgesa është bërë me qëllimin që djali të tërheqë paratë dhe t'i bëjë një surprizë nënës me një buqete me lule me rastin e ditëlindjes, pasi vetë I. M ndodhej në Angli në pamundësi për të qenë vetë pranë familjes.*

168. **AK Invest**, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.08.2023, konfirmon në emër të Kujtim Gjoka, një tërheqje në vlerën 33.701 lekë, nga G. S., në datë 05.12.2019.

*168.1 Me inventarin e datës 01.03.3034, subjekti ka dorëzuar sqarime me shkrim, ku sqaron se lidhur me konfirmimin e AK Invest, bërë me shkresën nr. \*\*\*, datë 18.08.2023, ku konfirmohet një tërheqje nga Kujtim Gjoka, në vlerën 33.701 lekë, në datë 05.12.2019, sqaron se kjo sasi lekësh i është dërguar nga shtetasi G. S., emigrant në Britaninë e Madhe, me qëllim mbulimin e shpenzimeve për disa vizita mjekësore të prindërve të tij, në Malin e Zi. Sqaron se shtetasi G. S. (aktualisht nuk jeton) ka qenë shok i ngushtë i tij, prej më shume se 20 vitesh.*

✓ **Subjekti ka dhënë sqarime lidhur me konfirmimet e AK Invest dhe Unionin Financiar si më sipër.**

169. ASHK, Drejtoria Vendore Shkodër, me shkresën nr. \*\*\*\* prot., datë 08.01.2024, konfirmon në emër të Gjon Gjoka, si më poshtë:

169.1 Leje legalizimi nr. \*\*\*\*, datë 23.09.2020, për godinë banimi dy kate, në emër të Gj. Ll. Gjoka dhe Ll. K. Gjoka, me adresë në Hajmel, Dheu i Lehtë, pasuria me nr. \*\*\*, zk. \*\*\*\*, me sipërfaqe parcele ndërtimore 324 m<sup>2</sup>, ndërtimi 108.9 m<sup>2</sup>, sipërfaqe totale e ndërtimit 242.9 m<sup>2</sup>. Bashkëlidhur praktika.

169.2 Deklaratë për përfshirje në procedurat e legalizimit, datë 18.08.2015, me nënshkrues Gj. dhe Ll. Gjoka, për ndërtim të ngritur në vitin 2011, me adresë Hajmel, Dheu i Lehtë. Bashkëlidhur praktika.

169.3 Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 20.11.2013, për pasurinë e llojit pemëtore + truall, me nr. \*\*\*, zk. \*\*\*, ndodhur në adresën Dheu i Lehtë, Shkodër, me sipërfaqe totale 859 m<sup>2</sup>, nga kjo truall 300 m<sup>2</sup>, ndërtesë 120 m<sup>2</sup>, në emër të Gj. dhe Ll. Gjoka. Bashkëlidhur praktika.

170. Me inventarin e datës 01.03.3034, subjekti ka dorëzuar sqarime me shkrim, se për sa i përket konfirmimit të ASHK-së, Drejtoria Vendore Shkodër, sqaron se leja e legalizimit nr. \*\*\*, datë 23.09.2020, për godinë banimi 2 kate, në emër të Gj. dhe Ll. Gjoka, me adresë në Hajmel, Dheu i Lehtë, Shkodër, pasuria me nr. \*\*\*\* zk. \*\*\*, nuk i përket babait të tij. Deklarata për përfshirje në procedurat e legalizimit, datë 18.08.2015, me nënshkrues Gj. dhe Ll. Gjoka për ndërtim në vitin 2011, me adrese Hajmel, Dheu i Lehtë, nuk i përket babait të tij.

171. Certifikata për vërtetim pronësie, datë 20.11.2013, për pasurinë e llojit pemëtore + truall, me nr. \*\*\*, zk. \*\*\*, ndodhur në adresën Dheu i Lehtë, Shkodër, në emër të Gj. dhe Ll. Gjoka, nuk i përket babait të tij. Sqaron se babai i tij Gjon Kol Gjoka, i datëlindjes 15.08.1946 dhe asnjë pjesëtar i familjes së tij, nuk ka të bëjë me pasuritë e përmendura më lart.

172. **Trupa e Vlerësimit mori në shqyrtim dokumentacionin e përcjellë nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Shkodër, nga ku rezultoi se Gjon Kol Gjoka me datëlindje 15.08.1946 dhe numër identifikimi E\*\*\*\*, nuk figuron në certifikatat familjare në dosjen nr. \*\*, datë 10.08.2015, Dheu i Lehtë, Hajmel, Shkodër, rrjedhimisht pasuria me nr. \*\*\*, zk. \*\*\* nuk është në pronësi të babait të subjektit.**

173. DPSHTRR, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 22.11.2023, nuk konfirmon mjet të regjistruar në emër të Davë dhe Gjon Gjoka.

174. DPT Tiranë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.08.2023, nuk konfirmon të regjistruar aktivitet në emër të subjektit apo personave të lidhur.

175. DPT Lezhë, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 24.08.2023, nuk konfirmon të regjistruar aktivitet në emër të subjektit apo personave të lidhur.

176. DPT Durrës, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.08.2023, nuk konfirmon të regjistruar aktivitet në emër të subjektit apo personave të lidhur.

177. ISSH, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 14.08.2023, konfirmon se M. Gj., përfiton pension pleqërie në masën 19.260 lekë, nga qershor 1998 dhe M. Gj. në masën 25.518 lekë, nga mars 2008.

178. Drejtoria e Përgjithshme Detare, me shkresat nr. \*\*\* prot dhe \*\*\* prot., datë 11.08.2023 dhe 22.11.2023, nuk konfirmon mjet lundruar në pronësi të subjektit apo personave të lidhur.

## **NË PËRFUNDIM TË HETIMIT TË KRYER MBI VLERËSIMIN E PASURISË,**

179. Trupa e Vlerësimit ka analizuar dhe verifikuar të dhënat e mbledhura nga institucionet e ndryshme në përputhje me Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar dhe në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, bazuar në parimin e kontradiktoritetit dhe në shpjegimet e subjektit z. Kujtim Gjoka, arriti në konkluzionin se:

- ✓ *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;*
- ✓ *Nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- ✓ *Nuk është kryer fshehje e pasurisë;*
- ✓ *Nuk është kryer deklarim i rremë;*
- ✓ *Subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.*

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

180. Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.

181. Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në tre elementë:

- (i) *të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të Nenit 36, pika 1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar;*
- (ii) *raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;*
- (iii) *verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të Nenit 36, pika 3, gërmra (ë), të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.*

182. Subjekti i vlerësimit, z. Kujtim Gjon Gjoka, në zbatim të Nenit 36, pika 2 e Ligjit nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, ka dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës në datën 08.05.2023.

183. Për kontrollin e figurës Trupa e Vlerësimit administroi:

- a. Deklaratën e “Kontrollit të Figurës”;
- b. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.

184. Në përputhje me nenin 42 pika 1, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, është përcjellë pranë Trupës së Vlerësimit raporti me Nr. \*\*\* Prot., datë 05.02.2024, i përpiluar me përgjigjet e ardhura nga institucionet publike dhe ato ligjzbatuese, verifikuese dhe informuese, ku është konstatuar përshtatshmëria e subjektit të vlerësimit z. Kujtim Gjoka.

185. Në deklaratën “Kontrolli i Figurës”, subjekti i vlerësimit ka deklaruar si vijon:

185.1 Në pjesën e parë të formularit, subjekti ka plotësuar të dhënat identifikuese.

185.2 Në pjesën e dytë të formularit, subjekti ka plotësuar të dhënat për vendbanimin.

185.3 Në pjesën e tretë të formularit, subjekti ka plotësuar të dhënat për arsimimin dhe kualifikimet.

185.4 Në pjesën e katërt të formularit, subjekti ka plotësuar të dhënat për punësimin.

185.5 Në pjesën e pestë të formularit, subjekti ka plotësuar të dhënat për sigurinë, si vijon:

- 1) Nuk është dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj.
- 2) Nuk ka qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet shqiptar ose i huaj.
- 3) Nuk ka qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligj zbatuese shqiptare apo të huaja për kryerjen e një vepre penale.
- 4) Ndaj tij nuk është caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi ose jo.
- 5) Nuk është lëshuar asnjëherë ndaj tij një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
- 6) Ndaj tij nuk është marrë asnjëherë masë dëbimi nga një shtet i huaj.
- 7) Subjekti ka deklaruar që nuk ka dijeni se ndonjë nga anëtarët e familjes së tij të jetë i përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.
- 8) Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme në formën e takimit, komunikimit elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës së subjektit.
- 9) Subjekti nuk është në dijeni që një nga anëtarët e familjes së tij të kenë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
- 10) Nuk ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- 11) Nuk ka dijeni se një person i familjes, ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
- 12) Nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s gjatë 10 viteve të fundit.
- 13) Nuk ka kërkuar azil politik në ndonjë shtet.

- 14) Nuk ka patur procedime penale dhe administrative, brenda dhe jashtë vendit, sipas neneve të ligjit për garantimin dhe integritetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
- 15) Nuk ka fshehur apo keq prezantuar, falsifikuar një informacion të një rëndësie të madhe, të një natyre sigurie të veçantë apo të ketë gënjyer gjatë plotësimit të formularit të deklaratës së kontrollit të figurës.
- 16) Nuk ka kryer shkelje sigurie, apo të ketë nëpërkëmbur në mënyrë të përsëritur rregullat e sigurisë së informacionit të klasifikuar, apo të ketë tentuar të kryej aktivitet të paautorizuar në sistemet e komunikimit të informacionit të klasifikuar.
- 17) Nuk ka qenë asnjëherë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Ish-Sigurimi i Shtetit para vitit 1991, sipas ligjit nr. 45/2015, “Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish-shërbimit të sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.
- 18) Nuk ka vuajtur nga çrregullime mendore kronike.
- 19) Nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
- 20) Nuk ka pasur asnjëherë varësi ndaj alkoolit apo lojërave të fatit.

186. Po ashtu, subjekti ka nëshkruar edhe dy vetëdeklarimet për vërtetësinë e të dhënave dhe saktësinë e tyre të paraqitura në deklaratën e kontrollit të figurës si dhe deklaratën për dhënien e pëlqimit për mbledhjen e të dhënave, kryerjen e kontrollit të figurës dhe aksesin për njohjen dhe administrimin e të dhënave personale.

## **HETIMI ADMINISTRATIV**

187. Për të vijuar me kontrollin tërësor të figurës dhe saktësinë e deklaramit të subjektit të vlerësimit lidhur me këtë aspekt, në bazë të nenit 36, të Ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, janë kryer veprimet duke kërkuar të dhëna nga institucionet agjencitë ligjzbatuese, ku ka rezultuar si vijon:

188. **Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile** me shkresën “E Paklasifikuar”, Nr. \*\*\* Prot., datë 07.08.2023, bën me dije se nuk ka ndryshim të gjeneraliteteve të subjektit të vlerësimit Z. Kujtim Gjon Gjoka.

189. **Institucion ligjzbatues**, me shkresën “I Kufizuar”, Nr.\*\*\* Prot., datë 09.08.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Kujtim Gjon Gjoka, bën me dije se nuk rezulton i dënuar.

190. **Institucion ligjzbatues**, me shkresën “Sekret”, Nr.\*\*\* Prot., datë 09.08.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Kujtim Gjon Gjoka, bën me dije se nuk ka të dhëna në lidhje me cenimin e sigurisë kombëtare, apo aktivitet të kundërligjshëm.

191. **Institucion ligjzbatues**, me shkresën “I kufizuar” Nr. \*\*\* datë 18.08.2023, për subjektin e vlerësimit, si dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, bën me dije se:

- Nuk kanë të dhëna apo indicie për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe të cenimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta;
- Nuk ka të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, (sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”) ku mund të përfshihen biseda, foto vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike, etj;
- Nuk kanë të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona (persona të dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të Ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar).
- Nuk kanë të dhëna në lidhje me hetimin ose gjykimin nga një autoritet shqiptar ose i huaj për kryerjen e një vepre penale;
- Nuk kanë të dhëna në lidhje me lëshimin e ndonjë urdhri ndërkombëtar, për kryerjen e një vepre penale;
- Nuk kanë të dhëna në lidhje me ndonjë masë dëbimi nga një shtet i huaj;
- Nuk kanë të dhëna nëse gjatë 10 viteve i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATOS;
- Nuk kanë të dhëna nëse nga subjekti është kërkuar azil politik në ndonjë shtet;
- Nuk ka procedim disiplinor apo masë disiplinore.

192. **Institucion ligjbatues**, me shkresën “Konfidencial”, Nr. \*\*\* Prot., datë 11.08.2023; për subjektin e vlerësimit Z. Kujtim Gjon Gjoka, bën me dije se nuk disponon të dhëna.

193. **Institucion ligjbatues** me shkresat “Sekret” datë 03.08.2023 dhe datë 06.10.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Kujtim Gjon Gjoka dhe personat e lidhur sipas certifikatës familjare, bën me dije se:

- Nuk kanë të dhëna për përfshirje në aktivitet të kundërligjshëm;
- Nuk ka procedime penale të referuara;
- Për subjektin e vlerësimit nuk disponohen ankesa, të dhëna ose informacione që lidhen me objektin e kërkesës.

194. **Institucion ligjbatues**, me shkresën “I Kufizuar”, Nr. \*\*\* Prot., datë 31.10.2023, për subjektin e vlerësimit Z. Kujtim Gjon Gjoka, bën me dije se:

- Nuk është nxjerrë urdhër ndalimi;
- Nuk është kërkuar masë e sigurimit personal;
- Nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale;
- Nuk ka pasur raste të urdhrave ndërkombëtar të ndalimit.



195. **Institucion ligjzatues**, me shkresat “I Kufizuar”, Nr. \*\*\* Prot., datë 02.08.2023 dhe datë 29.05.2024, për subjektin e vlerësimit Z. Kujtim Gjon Gjoka, bën me dije se:

- Nuk është nxjerrë urdhër ndalimi;
- Nuk është kërkuar masë e sigurimit personal;
- Nuk është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 dhe 35 të Kodit të Procedurës Penale;
- Nuk ka pasur raste të urdhrave ndërkombëtar të ndalimit.

196. **Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar**, me shkresën “I Kufizuar”, Nr. \*\*\* Prot., datë 15.08.2023; për subjektin e vlerësimit Z. Kujtim Gjon Gjoka, bën me dije se:

- Është i pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP), nivelin “Tepër Sekret” lëshuar më datë 23.02.2022, e vlefshme deri më datë 22.02.2027.
- Nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm të CSP.
- AKSIK nuk disponon rekorde për shkelje sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”, të NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

197. **Avokati i Popullit** me shkresën “E Paklasifikuar”, Nr. \*\*\* Prot., datë 14.08.2023; për subjektin e vlerësimit Z. Kujtim Gjon Gjoka, bën me dije se:

- Nuk ka njoftime apo ankesa nga publiku në lidhje me veprime apo mosveprime në kundërshtim me ligjin gjatë kryerjes së detyrës.
- Nuk ka nisje të hetimit administrativ për shkelje të kryera nga subjekti.

198. **Institucioni ligjzatues**, me shkresën “I kufizuar”, Nr. \*\*\* Prot., datë 24.11.2023; për subjektin e vlerësimit Z. Kujtim Gjon Gjoka, bën me dije se nuk ka qenë në ndjekje për spiunazh, terrorizëm si dhe anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri 2 Korrik 1991.

#### **Testi për përdorim lëndësh narkotike:**

199. Subjekti i vlerësimit në zbatim të pikës 2, të nenit 38, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, ka kryer testin mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike. Në bazë të rezultateve të përfituara testimi për përdorim lëndësh narkotike, konkludohet se në mostrën e urinës marrë subjektit me kod shifror \*\*\*\*, mbyllur në kontenier **nuk u zbulua** prania e produkteve të testuara.

#### **NË PËRFUNDIM TË HETIMIT TË KRYER PËR KONTROLLIN E FIGURËS:**

200. Trupa e vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pas një hetimi të thelluar të kontrollit të figurës për subjektin e vlerësimit Kujtim Gjoka, nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e deklarimit për kontrollin e

figurës, analizimit dhe verifikimit të të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe agjencitë ligjzbatuese, vlerësimit të testit për përdorim lëndësh narkotike, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me Ligjin nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” i ndryshuar, arriti në konkluzionin se:

- ✓ *Subjekti i vlerësimit z. Kujtim Gjon Gjoka, ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi.*
- ✓ *Nuk ka informacion në deklaramin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.*

### C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

201. Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45 dhe 47, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, si dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të Policisë së Shtetit.

202. Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në dy elemente:

- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar;
- Raportin e përgatitur nga Policia e Shtetit sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

203. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në përputhje me nenin 46 pika 2, të ligjit nr. 12/2018 të ndryshuar, ka përcjellë pranë Trupës së Vlerësimit, për subjektin e vlerësimit z. Kujtim Gjoka, raportin e vlerësimit të aftësive profesionale me Nr. \*\*\* Prot., datë 06.09.2023, të përpiluar në mënyrë të hollësishme dhe të arsyetuar, ku ka rezultuar *i kualifikuar për të ushtruar funksionin që mban.*

### HETIMI ADMINISTRATIV

204. Subjekti i vlerësimit z. Kujtim Gjon Gjoka, në momentin e dorëzimit të dokumentacionit në zbatim të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka ushtruar funksionin e Zv/Drejtorit për Sigurinë dhe Policimin në Komunitet, në Drejtorinë Vendore të Policisë Kukës.

205. Në zbatim të pikës 2 dhe 3 të nenit 44, të Ligjit nr. 12/2018, ku përcaktohet se periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij ligji, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën/pozicionin që mban, jo më shumë se 5 (pesë) vjet. Subjekti i vlerësimit Kujtim Gjoka, nga viti 2018 e deri aktualisht, ka qenë pjesë e Policisë së Shtetit.

206. Vlerësimi i aftësive profesionale mbështetet në:

- Të dhënat e administruara në dosjen personale të subjektit me nr. \*\*\*\*;
- Të dhënat e administruara në sistemin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore Sistemi RMIS, me numër RMIS \*\*\*\*\*;
- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të Nenit 44, pika 1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, të mbështetura në dokumentacionin shoqërues të dorëzuara nga vetë subjekti;
- Të dhënat e siguruara nga Drejtoria e Standardeve Profesionale mbi performancën e subjektit.

### **Në Formularin e Aftësive Profesionale subjekti deklaron:**

207. **Të dhëna për Arsimimin**

207.1 Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimit dhe përshtatshmëria me kriteret e pozicionit të punës, sipas parashikimit të nenit 45, pika 2/a, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar.

207.2 Pas administrimit të kopjes së dosjes personale të punonjësit, subjekti i vlerësimit rezulton se ka arsimin e lartë si më poshtë:

- Akademia e Policisë – periudha 1994 – 1997, Tiranë.

207.3 Pas verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar;

✓ **Subjekti përmbush kriterin e nivelit arsimor për funksionin që ushtron pranë Policisë së Shtetit, në momentin e dorëzimit të deklaratës së vlerësimit të aftësive profesionale.**

208. **Certifikatat e trajnimeve, kualifikimeve dhe medaljet**

207.1 Sipas të dhënave të administruara në dosjen personale të subjektit, të përcjella me raportin e vlerësimit të aftësive profesionale, rezulton se ai ka kryer trajnimet, si më poshtë vijon:

2005 Kursin e drejtimit strategjik për drejtuesit e lartë të Policisë së Shtetit

2009 Për të njohur mbylljen me sukses të programit të zhvillimit ekzekutiv, ILEA

2010 Kurs i avancuar për menaxhimin për nivelin e mesëm drejtues

2012 Përfunduar kursin e kundërveprimit të lidërshiptit

2006 Specialist teknik

2006 Ka marr pjesë në trajnimin “Mbikëqyrja dhe mbijetesë në shërbim”

2011 Ka përfunduar me sukses kursin për gradën Kryekomisar

2011 Kurs për implementimin e teknologjisë elektronike për hetimin dhe proces bashkëpunimi ndërkombëtar të policisë

2019 Trajnim “Analiza, Planifikimi, Monitorimi dhe Vlerësimi”.

207.2 Gjithashtu, gjatë karrierës rezulton se subjekti ka marrë certifikatë për performancë të lartë në realizimin e detyrave, e konkretisht në vitin 2018: *Certifikatë “Shërbime të dalluara”*.

207.3 Nga verifikimi i të dhënave të administruara, rezulton se:

- ✓ *Deklarimi i subjektit të vlerësimit është i saktë.*
- ✓ *Subjekti ka kryer trajnime/specializime, si dhe ka marrë cetrifikatë, në përputhje me funksionin që ushtron.*

## 209. Vlerësimet e punës

209.1 Nga dokumentacioni i dorëzuar pranë Trupës së Vlerësimit, për periudhën 2018-2022, janë administruar 4 (katër) vlerësime të aftësive individuale të punës (nga 5 (pesë) që duhej të ishin), si dhe bazuar në sistemin e vlerësimit dhe pikëzimit të rezultateve të punës për performancën vjetore, rezulton se subjekti është vlerësuar me “*Shumë mirë*” për punën e kryer.

209.2 Vlerësimi i aftësive individuale të punës sipas standardeve të përcaktuara bëhet nga eprori i drejtpërdrejtë, bazuar në vlerësimin e integritetit, profesionalizmit, komunikimit, qëndrimit konstruktiv, paanshmërisë, punës në grup si dhe planifikimit dhe organizimit të punës.

209.3 Bazuar në vlerësimet e mësipërme të administruara nga Trupa e Vlerësimit, konstatohet:

- ✓ *Subjekti ka përmbushur detyrat profesionale, ka respektuar rregullat e etikës, si edhe ka shfaqur performancë të lartë funksionale.*

## 210. Masat disiplinore

210.1 Referuar raportit të dërguar nga Policia e Shtetit, ku konfirmon se ka verifikuar dokumentacionin në dosjen personale të subjektit, rezulton së gjatë periudhës 5 vjeçare, (2018 - 2022) të përcaktuar në pikën 2, të nenit 44, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit:

- ✓ *Nuk është ndëshkuar me masë disiplinore.*
- ✓ *Deklarimi i subjekti është i saktë.*

## 211. Ecuria në karrierë

211.1 Nga verifikimi në dosjen personale rezulton se gjate periudhës 5 vjeçare objekt deklarimi, subjekti Kujtim Gjoka , ka ecurinë në karriere si vijon:

01.12.2023 - Aktualisht Zëvendës drejtor për hetimin e krimeve, Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër.

10.04.2023 - 30.11.2023 Zëvendësdrejtor për Sigurinë dhe Policimin në Komunitet, Drejtoria Vendore e Policisë Kukës.

20.03.2023 - 09.04.2023 Specialist Sektori, në Drejtorinë e Rendit Publik, DPP.

20.02.2023 - 19.03.2023 Specialist, në Drejtorinë e Menaxhimit dhe Drejtimit, DPP.

05.11.2021 - 28.02.2023 Shef Komisariati, Komisariati i Policisë, Malësi e Madhe.

15.01.2021 - 04.11.2021 Zv/Drejtor për hetimin e krimeve, në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër.

21.05.2018 - 14.01.2021 Shef sektori i analizës strategjike, planifikimit, monitorimit dhe vlerësimit, në Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë.

214.2 Në lidhje me përputhshmërinë e gradës me funksionin/pozicionin e punë, subjekti i vlerësimit ka përfituar gradat si më poshtë:

- Drejtues 01.06.2024 – aktualisht
- Kryekomisar 18.07.2011 – 31.05.2024

214.3 Në përfundim, në lidhje me ecurinë në karrierë të z. Kujtim Gjon Gjoka, bazuar në deklaratimet e bëra, verifikimet nga dokumentacioni i administruar, trupa e vlerësimit konstaton se:

- ✓ **Funksionet në të cilat është emëruar subjekti dhe gradat e përfituara gjatë karrierës, janë në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.**

212. **Pjesëmarrja në konferenca shkencore, workshop-e, seminare, botime brenda dhe jashtë vendit.**

212.1 Subjekti i vlerësimit, z. Kujtim Gjon Gjoka, për periudhën e përcaktuar në formularin e aftësive profesionale, ka marrë pjesë në konferenca dhe workshope jashtë vendit.

## **NË PËRFUNDIM TË HETIMIT TË KRYER PËR VLERËSIMIN E AFTËSIVE PROFESIONALE,**

213. Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi kreu një hetim të thelluar nëpërmjet verifikimit të dosjes personale të subjektit të vlerësimit, verifikimit të nivelit arsimor të subjektit të vlerësimit, vlerësimin e përmbushjes së detyrave funksionale dhe respektimin e rregullave të etikës në ushtrimin e detyrës si punonjës në Policinë e Shtetit, arrin në konkluzionin se, subjekti i vlerësimit z. Kujtim Gjoka:

- ✓ **Është i përshtatshëm duke pasur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;**
- ✓ **Ka rezultuar i kualifikuar për të ushtruar atë funksion që mban;**
- ✓ **Ka vlerësime pozitive pune.**

## KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të vlerësimit, relacionin e relatores së çështjes, shpjegimet me shkrim të dhëna nga subjekti i vlerësimit gjatë hetimit administrativ, si dhe pasi u njoh me qëndrimin e subjektit të vlerësimit në seancën dëgjimore publike të datës 08.10.2024, ftoi subjektin në seancën e dhënies së vendimit të datës 18.10.2024, arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, z. Kujtim Gjon Gjoka, në përputhje me nenin 60, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- *Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë;*
- *Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës;*
- *Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.*

### PËR KËTO ARSYE:

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në bazë të gërmës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2, të nenit 60, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar;

### V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit, z. **Kujtim Gjon Gjoka**, me funksion Zëvendësdyrëtor për Hetimin e Krimeve në Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë Mbikëqyrjes Policore në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

*Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë 18.10.2024.*

### TRUPA E VLERËSIMIT

**Erjana PJETRI**

**Kryesuese**

**Ersa KARAJ**

**Relatore**

**Klevis DHIGOI**

**Anëtar**